

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK



Për Programin e studimit

Master i Shkencave në “Shkenca juridike”,
me drejtime: a) “E drejtë publike dhe administrative”; b) “E drejtë private”; c)
“E drejtë penale”, ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

PhD. Ildir Peci

Dr. Artan Spahiu



(Tetor/2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Master i Shkencave në “Shkenca juridike”, me drejtime: “E drejtë publike dhe administrative”;
“E drejtë private”; “E drejtë penale”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 408, datë 26.05.2010 Miratuar ndryshimet me Shkresë të MASR Nr. 4932/1, dt. 05.06.2018
4	Urdhëri/VBA e Akreditimit të parë:	VBA Nr.49, datë19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Shkenca juridike”, me drejtime: “E drejtë publike dhe administrative”; “E drejtë private”; “E drejtë penale”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/4 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti Privat “Albanian University”
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Numri i studentëve:	
	2017-2018	65
	2018-2019	71

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca juridike”, me drejtime: “E drejtë publike dhe administrative”; “E drejtë private”; “E drejtë penale”.

Ky program studimi është licencuar me VKM Nr.408 datë 26.05.2010 dhe është akredituar me Vendim Nr. 49, datë 19.05.2017 të Bordit të Akreditimit.

Sipas pikës 3 të VKM Nr. 408, datë 26.5.2010 “Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë”, është miratuar hapja, në Shkollën e Lartë Private “UFO University”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë, në “Shkenca juridike”, në formën e studimeve me kohë të plotë, me drejtime: a) Marrëdhënie ndërkombëtare; b) E drejtë publike dhe administrative; c) E drejtë private; ç) E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Europian; d) E drejtë penale. Ky program studimi i ciklit të dytë është miratuar të realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike. Po sipas VKM Nr.408/2010, në përfundim të programeve të studimeve duhet tëlëshohet “Diplomë e nivelit të dytë” (DND), në “Shkenca juridike”, në drejtimet: a) Marrëdhënie ndërkombëtare; b) E drejtë publike dhe administrative; c) E drejtë private; ç) E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Europian; d) E drejtë penale. Dy prej profileve të këtij programi studimi, përkatësisht profilet: “Marrëdhënie ndërkombëtare” dhe “E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Europian” nuk janë aktive, nuk janë të akredituara dhe nuk janë objekt i këtij vlerësimi.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. **PhD. Ildir Peçi**
2. **Dr. Artan Spahiu**

Koordinatorë Teknikë e ASCAL për këtë program studimi është Zj. Ersi Dako.

Më datë 10.10.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 128/58 Prot., datë 11.10.2019, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 17.10.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 495/1 Prot., Institucioni përcjell përgjigjen mbi Draft-Raportin. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me këto komente, jep argumentimin si vijon:

MEMO

Për analizimin e komenteve mbi Draft- Raportin e vlerësimit të jashtëm periodik, për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”, me drejtime: a) “E drejtë publike dhe administrative”; b) “E drejtë private”; c) “E drejtë penale”, ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Pasi u njohëm me përgjigjet e dhëna nga IAL në vlerësim, Albanian University, mbi Draft- Raportin e vlerësimit të jashtëm periodik, për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”, me drejtime: a) “E drejtë publike dhe administrative”; b) “E drejtë private”; c) “E drejtë penale”, ju paraqesim opinionin tonë si më poshtë:

I. Në lidhje me komentin e dhënë në pikën 1, faqe 1 të Përgjigjes së IAL-së mbi Draft-Raportin, për standardin I.3, Kriteri 2, fq.7, si vijon: *“Edhe pse shpresonim që ky argument ishte sqaruar gjatë vizitës në institucion, sqarojmë përsëri, për secilin profil studentit siguron më shumë se 60 ECTS që I korrespondojnë një viti akademik, edhe nëse disa nga lëndët janë të përbashkëta, ato justifikojnë plotësisht emërtimin Master i Shkencave në Shkenca Juridike (profili...). Kjo është edhe arsyeja që studentit nuk mund të limitohet në zgjedhjen e temës së diplomës sipas profilit, edhe pse logjikisht, kjo nuk ka ndodhur asnjëherë”*, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm nuk e merr në konsideratë këtë koment. Në analizën përkatëse, nuk mohohet që *de facto* studentët zgjedhin temën e diplomës sipas profilit edhe pse kjo gjë nuk është e detyrueshme. Përkundrazi, në analizë merret i mirëqënë ky fakt. Megjithatë, edhe po të llogarisim që tema zgjidhet sipas profilit studentët sigurojnë në total në një profil të caktuar 54 ECTS, pra më pak se gjysma e krediteve të të gjithë programit.

II. Në lidhje me komentin e dhënë për Standardin III.5 Kriteri 3. fq.20 të Draft-Raportit, si vijon: *“Sqarojmë se pas vizitës së GVJ-së, në institucion është kërkuar një informacion për temat e përzgjedhura nga studentët, këtë informacion e dërguam menjëherë, por mund të kishim pasqyruar edhe pedagogët udhëheqës për secilin student, gjithsesi e përcjellim këtë informacion, duke ritheksuar çka shkruhet në RVB, mbi numrin maksimal të udhëheqjeve për secilin pedagog”*, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm mori në konsideratë komentin dhe evidencën shtesë (shtojca Nr. 2), të paraqitur bashkëngjitur komenteve dhe e riformulon vlerësimin e tij për këtë kriter si më poshtë:

“Nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, si dhe nga sqarimi i dhënë me shkrim nga IAL mbi Draft-Raportin, konkludohet se udhëheqësi i tezës për mbrojtjen e diplomës së studentëve të këtij programi (Master i Shkencave) ka të paktën gradën shkencore “Doktor i Shkencave”. Gjithashtu, numri maksimal i studentëve të udhëhequr nuk ishte më i madh se 10 (dhjetë)”.

Në fund të vlerësimit tek “Konkluzionet e vlerësimit”, për standardin III, pika 4 (faqe 22 e Draft-Raportit) ndryshohet si më poshtë:

“4. IAL angazhon stafin akademik me tituj dhe grada në mentorimin e studentëve për hartimin e tezave të diplomave”.

III. Në lidhje me komentin e dhënë në pikën 3, faqe 2, të Përgjigjes së IAL mbi Draft-Raportin, si vijon: *“Nuk e ekzagjerojmë të themi, që procedura e rekrutimit në AU është ndër më transparentet që ekzistojnë në IAL-të Shqiptare, publike dhe private. Vlerësojmë pozitivisht sygjërimin tuaj për*

përcaktimin në njoftimin e vendeve vakante, ndarjen në pikë të vlerësimit, edhe nëse do të ishim të parët që do të konsolidonim këtë praktikë, në IAL-të Shqiptare. Sidoqoftë, në lidhje me ankimin, cilido nga subjektet e interesuara do të kishte më shumë argumenta për ta ankimuar, dhe fakti që kjo nuk ka ndodhur, shpjegon që nuk është shkelur asnjë e drejtë apo interes legjitim”, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm nuk e merr në konsideratë komentin.

Konkluzioni i dhënë nga ekspertët tek “Konkluzionet e vlerësimit” për standardin III, pika 5 (faqe 22 e Draft-Raportit) qëndron ashtu sikurse është pasqyruar aty: **“IAL nuk ndjek procedura publike transparente konkurimi për rekrutimin e personelit akademik, të bazuara në vlerësimin/pikëzimin e kritereve të pranimit, të miratuara paraprakisht”**. Pretendimi i përfaqësuesve të IAL-së se *“Procedura e rekrutimit në AU është ndër më transparentet që ekzistojnë në IAL-të Shqiptare, publike dhe private”* është vetëm një vlerësim subjektiv dhe nuk përbën argument. Nga ana e ekspertëve, arritja në këtë konkluzion është bërë duke krahasuar faktin e gjetur në IAL me parashikimin e nenit 30 të Rregullores së Përgjithshme të IAL-së, të miratuar në 03.05.2017. Sqarimi i bërë nga ekspertët në lidhje me këtë pikë, në faqen 16 të Draft-Raportit, në paragrafin “Neni 30, pika 5 dhe 6 e Rregullores parashikon që.....”, është shumë i qartë dhe i detajuar.

IV. Në lidhje me komentin e dhënë në pikën 5, faqe 2, të Përgjigjes së IAL mbi Draft-Raportin (Rubrika 9. STUDENTËT, Konkluzione, pika 1, fq.49), si vijon: **“Komisioni i Pranimit njihet me aplikimin e studentëve dhe vlerëson këto aplikime në përputhje me nenin 10 të rregullores së programit, ku përcaktohen kriteret e pranimit dhe vendos për reanimin, mbi të gjitha kur studentët vijnë nga një program i përafërt studimi. Sipas rregullores, komisioni i pranimit mund të vendosë edhe kritere shtesë të cilat miratohen nga Senati Akademik, sipas përcaktimeve ligjore, por kriteri i notës mesatare për t’u pranuar në këtë program nuk është vendosur asnjëherë deri më sot”**, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm nuk e merr në konsideratë komentin.

Grupi i ekspertëve i mbetet konkluzionit të dhënë në pikën 1, faqe 49 të Draft-Raportit: **“.....Por ngritja e komisionit të pranimit ka qenë thjesht një procedurë formale e Departamentit për të respektuar formalisht një kërkesë të Rregullores.....”**. Grupi i ekspertëve i mbetet sqarimit të bërë, në lidhje me këtë pikë, në faqen 45 të Draft-Raportit dhe konkretisht: “Pavarësisht se Komisioni i Pranimit është ngritur nga Departamenti, sikurse e parashikon rregullorja, nuk evidentohet ndonjë shkresë apo procesverbal i këtij komisioni që të vërtetojë se ka qenë ky komision ai që ka miratuar kriteret akademike (psh. që ka miratuar **notën mesatare**) të pranimit të studentëve apo ndonjë dokument që provon se dokumentat e paraqitura nga studentët janë verifikuar dhe vlerësuar nga ky komision. Sipas të dhënave të marra nga biseda me sekretarinë e Fakultetit (nga minutat gjatë vizitës në institucion), pyetjes: *“Notën mesatare të studentëve në hyrje, kush e verifikon?”*, ju përgjigjën: *“Nota mesatare verifikohet nga sekretaria mësimore, nga lista e notave që sjellin studentet”*. Pra ngritja e komisionit të pranimit ka qenë thjesht një procedurë formale e Departamentit për të respektuar formalisht një kërkesë të Rregullores. Sikurse konstatohet dhe nga tabelat në anekse, nota mesatare e pranimit të këtyre studentëve ka qenë e ndryshme në vite dhe profile të ndryshme dhe nuk ka dokumenta që provojnë se kjo notë mesatare është miratuar për çdo vit akademik dhe për çdo profil nga komisioni i pranimit”.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E KONSTATIMEVE NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË TË BA

Me Vendimin Nr. 49 datë 19.05.2017 të Bordit të Akreditimit të ASCAL "Për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Shkenca juridike", me drejtime: "E drejtë publike dhe administrative"; "E drejtë private"; "E drejtë penale", të Universitetit Privat "Albanian University", është vendosur **vlerësimi përfundimtar POZITIV** për programin e studimit në fjalë, si dhe akreditimi i këtij programi me kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike (deri më 31.07.2019).

I. Konstatimet e Bordit të Akreditimit:

Në vendimin e akreditimit të parë Nr. 49/2017 nuk janë lënë rekomandime. Në faqen 2 të Vendimit Nr. 49/2017 janë evidentuar disa pika të dobëta të konstatuara nga procesi i vlerësimit të jashtëm dhe konkretisht:

- a. Stafi akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi nuk mbulon 70% të ngarkesës mësimore;
- b. Praktika nuk është përfshirë si lëndë/modul i veçantë në kurrikulën e programit të studimit;
- c. Studentët nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në botime shkencore;
- d. Vlerësimi i procesit të mësimdhënies dhe nxënies realizohet vetëm në rang institucional;
- e. Nuk është realizuar një studim tregu lidhur me nevojat e tregut për këtë program studimi.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

Vlerësimi nga ekspertët e jashtëm për masat e marra nga IAL e vlerësuar, për këto pika të dobëta, të konstatuara nga akreditimi i parë, paraqitet si më poshtë:

- a. Për vitin akademik 2017-2018 vazhdon të evidentohet e njëjta dobësi dhe kriteri nuk ishte përmbushur, pasi raporti midis orëve mësimore të mbuluar nga stafi i brendshëm dhe atyre të mbuluara nga stafi i jashtëm është **33.9%** me **66.1%**. Për vitin akademik 2018-2019 ky raport është përmirësuar, pasi personeli akademik me kohë të plotë mbulon pothuajse **70% (69.5%)** të ngarkesës mësimore. Pra për vitin 2018-2019 janë marrë masa dhe ky kriter është përmbushur kryesisht. **Ky konstatim është përmbushur kryesisht.**
- b. Për vitin akademik 2018-2019, praktika është përfshirë si lëndë/modul i veçantë në kurrikulën e programit të studimit. **Ky konstatim është përmbushur.**
- c. Studentët përsëri nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në botime shkencore. **Ky konstatim është përmbushur pjesërisht.**
- d. Vlerësimi i procesit të mësimdhënies dhe nxënies realizohet edhe në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. **Ky konstatim është përmbushur.**
- e. Është hartuar si dokument një "Analizë për Tregun e Punës", për programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca juridike", me drejtime, për vitin akademik 2018-2019, por më shumë ai i referohet objektivave të programit të studimit dhe disa të dhënave të INSTAT-it për numrin e papunësisë. Nuk ka një analizë apo studim të vërtetë mbi numrin e studentëve të punësuar si jurist, që do të justifikonte nevojën e hapjes së këtij programi studimi. **Ky konstatim është përmbushur pjesërisht.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca juridike”, me drejtime: 1. E Drejtë Publike dhe Administrative; 2. E Drejtë Private; 3. E Drejtë Penale; 4. E Drejtë Ndërkombëtare dhe e Bashkimit European; 5. Marrëdhënie Ndërkombëtare, është licensuar me VKM Nr. 498, dt. 26/05/2010 dhe është akredituar për herë të parë me vendim Nr. 49, dt. 19/05/2017 të Bordit të Akreditimit. Vetëm tre profilet e para të përmendura më sipër janë aktive.

Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies për këtë program janë përcaktuar në Rregulloren e Studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike (**Evidencë 1.1, Kreu II, neni 4**). Objektivat për kërkimin shkencor janë të përcaktuara në Planin Strategjik të Departamentit të Shkencave Juridike, viti akademik 2018-2019 (**Evidencë 1.2, Objektiv 2**). Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor nuk janë përcaktuar shprehimisht për programin në fjalë, por për Departamentin e Shkencave Juridike në përgjithësi. Kjo në vetvete nuk përbën ndonjë problem, për sa kohë këto objektiva dhe qëllime janë të mirëpërcaktuara.

Albanian University ka adoptuar Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022 (**Evidencë 1.4**) ku përcaktohen objektivat e IAL në vitet përkatëse. Ky Plan Strategjik, përmend në disa raste disa objektiva afatmesme, në disa raste të tjera objektiva të cilat duhen të zhvillohen brenda një afati kohor të caktuar, por nuk përmend objektiva afatshkurtra ose afatgjata. Për më tepër, nuk është e qartë se në bazë të çfarë kriterëve cilësohet një objektiv si afatmesëm. Plani strategjik në fjalë nuk është i shoqëruar nga një Plan Veprimi me masa konkrete dhe të matshme nëpërmjet indikatorëve dhe shtrirjes kohore në faza sipas çdo mase dhe indikatorit matës. Departamenti i Shkencave Juridike nga ana tjetër, ka hartuar një Plan Strategjik për vitin akademik 2018-2019 (**Evidencë 1.2**). Ky Plan Strategjik përmban katër objektiva, të cilët në fakt nuk janë objektiva të mirëfilltë, por një përshkrim i çfarë është arritur dhe çfarë strukturash egzistojnë (përfshirë këtu bën kërkimi shkencor, ku parashikohet organizimi i një sërë konferencave). Plani Strategjik është shoqëruar nga një Plan Masash (**Dokument 10, Plani i masave të dërguar mbas vizitës në IAL**). Megjithatë, objektivat e këtij Plani Masash nuk përputhen me objektivat e Planit Strategjik për vitin akademik 2018-2019. Kjo vjen, në rradhë të parë, si pasojë e paqartësisë së formulimit të objektivave të Planit Strategjik. Gjithashtu, masat e parashikuara për çdo objektiv në Planin e Masave nuk janë të matshme nëpërmjet indikatorëve konkretë. Ato janë thjeshtë një listë me formulime të përgjithshme dhe pa masa konkrete.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.

Programet e ofruara nga Departamenti i Shkencave Juridike në të dy ciklet e studimit janë në përputhje me strategjinë, vizionin dhe misionin e IAL. Sipas Rregullores së Përgjithshme të AU, programet e studimit organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë (Bachelor), cikli i dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional) dhe cikli i tretë (Doktoratura dhe Specializimet Afatgjata). Programet që janë objekt i këtij akreditimi i përkasin ciklit të dytë. Misioni kryesor i AU-së në përgjithësi dhe i Departamentit të Shkencave Juridike në veçanti është të përgatisë profesionistë të aftë si nga pikëpamja teorike ashtu dhe nga ana praktike, duke i pajisur studentët me njohuri themelore në shkencat juridike, kryesisht në fushën private, publike dhe atë penale, si dhe duke i pajisur ata me aftësi, zotësi dhe shprehi të formimit juridik. (Evidencë 1.3, neni 36, fq. 34; Evidencë 1.2. Kreu II neni 4; Evidencë 1.4, fq. 3).

Departamenti i Shkencave Juridike ka kryer një Analizë për Tregun e Punës për Programin Master i Shkencave në Shkenca Juridike, viti akademik 2018-2019 (Evidencë 7.7). Kjo analizë bazohet në të dhëna të përgjithshme të institucioneve të ndryshme dhe studime të kryera nga to. Analiza nuk është e fokusuar në nevojat e tregut për juristë në veçanti. Si rrjedhojë, nuk është e qartë nëse programi i studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike është i hartuar në përputhje me nevojat e tregut. Nga vizita në IAL rezultoi se Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave angazhohet çdo vit në rishikimin e programeve mësimore. Megjithatë, rishikimi i programit studimor fokusohet më tepër në nevojat e brendshme të Departamentit dhe jo në zhvillimin ekonomik të vendit (Dokument 11.2, Raport Vjetor 17-18, i dërguar mbas vizitës në IAL).

Programet e studimit nuk bien ndesh me interesat kombëtarë dhe pasqyrojnë vullnetin e IAL për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të

institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	AU ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022 (Evidencë 1.4) ku pasqyrohen objektivat dhe qëllimet e IAL. Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar strategjinë e tij (Evidencë 1.2) si dhe planin e masave për realizimin e strategjisë(Dokumenti 10,Plani i masave, i dërguar mbas vizitës në IAL). Pavarësisht mospërputhjeve të planit të masave me strategjinë, mund të thuhet që programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë e zhvillimit institucional.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Referuar Ligjit Nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 <i>“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i> dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, mund të thuhet që përmbajtja e programit është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Emërtimi i programit të studimit është Master i Shkencave në “Shkenca juridike” dhe është në përputhje me nivelet e përcaktuara nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Megjithatë, shtesa e emërtimit me profile në “E drejtë publike dhe administrative”, “E drejtë private” dhe “E drejtë penale” nuk është plotësisht e justifikuar, duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e formimit profilizues që merr studenti. Programi përmban 120 ECTS, të cilat përftohen duke kaluar me sukses 11 lëndë të detyrueshme për të gjithë studentët, pavarësisht profilit të zgjedhur prej tyre. Nëse marrim për shembull profilin “E drejtë penale”, studenti përfton nga lëndët e profilit penal 36 ECTS, 18 nga dy lëndë të detyrueshme dhe 18 nga tre lëndët me zgjedhje. Nga vizita në IAL rezultoi se studentët nuk janë të detyruar të zgjedhin temën e diplomës në përputhje me profilin e zgjedhur. Megjithëse, nga dokumentacioni i dërguar rezulton që temat e zgjedhura për vitin akademik 2018-2019 janë në përgjithësi në përputhje me profilet e zgjedhura (Dokumenti 28, Lista e Temave të Diplomës për Msc, i dërguar mbas vizitës në IAL). Pra, në rastin më të mirë, kur studenti zgjedh temën e diplomës në përputhje me

	profilin përkatës, totali i ECTS që përftohet sipas profilit “E drejtë penale” do të jetë 54, më pak se gjysma e ECTS të të gjithë programit.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>AU ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit Insitucional 2017-2022 ku një nga objektivat e tij është dhe përmirësimi i programeve të studimit (Evidencë 1.4, fq. 11). I njëjti Plan Strategjik parashikon nëpërmjet NJSBC përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit (Evidencë 1.4, fq. 18). Megjithatë, ky Plan Strategjik nuk është i shoqëruar me një plan veprimi me masa konkrete dhe të matshme dhe me afate të qarta që synojnë realizimin e këtyre rezultateve. Departamenti i Shkencave Juridike nga ana tjetër, ka hartuar një Plan Strategjik për Vitin Akademik 2018-2019 (Evidencë 1.2). Ky Plan Strategjik është shoqëruar nga një Plan Masash (Dokumenti 10, Plani i masave, i dërguar mbas vizitës në IAL). Megjithatë, objektivat e këtij Plani Masash nuk përputhen me objektivat e Planit Strategjik për Vitin Akademik 2018-2019. Gjithashtu, masat e parashikuara për çdo objektiv nuk janë të matshme nëpërmjet indikatorëve konkretë.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programet e ofruara nga Departamenti i Shkencave Juridike në të dy ciklet e studimit janë në përputhje me strategjinë, vizionin dhe misionin e IAL. Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave angazhohet çdo vit në rishikimin e programeve mësimore. 2. Programet e studimit nuk bien ndesh me interesat kombëtarë dhe pasqyrojnë vullnetin e IAL për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. 3. Programet e studimit janë përshtatur me strategjinë e zhvillimit institucional. Përbajtja e programit është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. 4. Emërtimi i programit të studimit është Master i Shkencave në “Shkenca juridike” dhe është në përputhje me nivelet e përcaktuara nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Shtesa e emërimit me profile në “E drejtë publike dhe administrative”, “E drejtë private” dhe “E drejtë penale” nuk është plotësisht e justifikuar, duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e formimit profilizues që merr studenti. 5. AU ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit Insitucional 2017-2022 ku një nga objektivat e tij është dhe përmirësimi i programeve të studimit. Ky plan nuk është i shoqëruar me një plan veprimi me masa konkrete dhe të matshme. 6. Departamenti i Shkencave Juridike ka hartuar një Plan Strategjik për vitin akademik 2018-2019. Ky Plan Strategjik është shoqëruar nga një Plan Masash, objektivat e të cilit nuk 	

përputhen me objektivat e Planit Strategjik për vitin akademik 2018-2019. Gjithashtu, masat e parashikuara për çdo objektiv nuk janë të matshme nëpërmjet indikatorëve konkretë.

2. Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Departamentit të Shkencave Juridike.

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është njësi kryesore e Universitetit në vlerësim (Albanian University) që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fusha të lidhura me profilet shoqërore. Struktura e këtij fakulteti, organet dhe autoritetet drejtuese të tij, si dhe kompetencat e tyre parashikohen në mënyrë të detajuar në aktet rregullatore nënligjore, të miratuara në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe që janë konkretisht:

- Statuti i IAL, miratuar në vitin 2016 (**evidenca 2.1 e RVB**);
- Rregullorja e Përgjithshme të IAL-së, miratuar në 03.05.2017;
- Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, miratuar më 28.12.2016 (**evidenca 2.2 e RVB**);
- Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Departamentit të Shkencave Juridike, miratuar më 28.02.2018.

Ndërsa përsa i përket programit të studimit *Master i Shkencave në “Shkenca juridike”, me drejtime: “E drejtë publike dhe administrative”; “E drejtë private”; “E drejtë penale”,* aspektet organizative të këtij programi, misioni dhe objektivat, si dhe kuadri i përgjithshëm formues rregullohen në mënyrë të detajuar në Rregulloren e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Shkenca juridike”, të miratuar në 08.11.2018.

Bazuar në nenin 14 të Statutit të Albanian University (miratuar në vitin 2016), Albanian University ka 3 Fakultete (njësi kryesore): Fakulteti i Shkencave Mjekësore (me 3 Departamente), Fakulteti i Shkencave Shoqërore (me 4 Departamente) dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (me 3 Departamente).

Bazuar në nenin 7 të Rregullosës së Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Fakulteti përbëhet nga organet drejtuese, autoritete drejtuese, njësitë bazë mësimore-shkencore (Departamentet) dhe nga administrata. Organ drejtues kolegjal është Dekanati dhe Asambleja e Personelit Akademik. Organ drejtues individual administrativ është Administratori i Fakultetit. Autoritete drejtuese akademike janë: Dekani dhe Përgjegjësit e Departamenteve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërjen e tij 4 njësi bazë mësimore-shkencore (Departamente), të cilat janë:

- a) Departamenti i Shkencave Juridike (që ofron programin e studimit, objekt vlerësimi);
- b) Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative;

- c) Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme;
- d) Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.

Organigrama e Fakultetit të Shkencave Shoqërore është ajo e paraqitur në dokumentat bashkëngjitur RVB, nga vetë IAL-ja në vlerësim (Evidenca 2.5 “Organigrama e Fakultetit”).

Përsa i përket numrit total të punonjësve të personelit akademik dhe administrativ të Departamentit të Shkencave Juridike, ai paraqitet si më poshtë:

Për vitin akademik **2017-2018**, Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga 121 punonjës, prej të cilëve 40 PAE, 66 PAK dhe 15 PA, me ndarjen sipas Departamenteve si në vijim:

1. Departamenti i Shkencave Juridike: 13 PAE / 19 PAK / 3 PA;
2. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative: 7 PAE / 14 PAK / 1 PA;
3. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme: 10 PAE / 18 PAK / 3 PA;
4. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes: 10 PAE / 15 PAK / 3 PA.

Për vitin akademik **2018-2019**, Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga 128 punonjës, prej të cilëve 39 PAE, 71 PAK dhe 19 PA, me ndarjen sipas Departamenteve si në vijim:

1. Departamenti i Shkencave Juridike: 10 PAE / 23 PAK / 6 PA;
2. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative: 8 PAE / 15 PAK / 3 PA;
3. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme: 10 PAE / 19 PAK / 3 PA;
4. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes: 10 PAE / 14 PAK / 3 PA.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit të Shkencave Juridike

Personeli akademik në Departamentin e Shkencave Juridike, për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 kategorizohen në: kategorinë (a) profesorë (Prof.Dr. dhe Prof.Asoc.Dr.); (b) lektorë (Dr./PhD); (c) asistent-lektorë (Msc). Personeli akademik është i punësuar me kohë të plotë (PAE – personel akademik efektiv) ose me kohë të pjesshme (PAK – personel akademik me kontratë).

Për vitin akademik **2017-2018**, Departamenti i Shkencave Juridike përbëhet nga 35 punonjës, prej të cilëve:

- 13 PAE, me kualifikimin: 1 Prof. As., 6 Dr., 2 Dr., proces dhe 4 Msc.;
- 19 PAK, me kualifikimin: 3 Prof., Dr., 4 Prof. As., 5 Dr., 2 Dr., proces dhe 5 Msc.;
- 3 PA, me kualifikimin: 1 Dr. proces, 1 Msc., dhe 1 Ba.

Për vitin akademik **2018-2019**, Departamenti i Shkencave Juridike përbëhet nga 39 punonjës, prej të cilëve:

- 10 PAE, me kualifikimin: 5 Dr., 1 MND., 2 Dr., proces dhe 2 Msc.;
- 23 PAK, me kualifikimin: 4 Prof., Dr., 4 Prof. As., 7Dr., 1 Dr., proces, 2 MND., 1 Mag. dhe 4 Msc.;
- 6 PA, me kualifikimin: 1 Dr. proces, 4 Msc., dhe 1 Ba.

Të dhenat për evidencat e mësipërme paraqiten në tabelën 1 dhe 2 të Anekseve.

Për çdo vit akademik hartohet dhe administrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike, *Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik PAE/PAK* në fushën akademike e kërkimore-shkencore (verifikuar edhe

gjatë vizitës në institucion si dhe nga evidencat shtesë të kërkuara).

Përsa i përket rekrutimit të stafit akademik, nga takimi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, u konstatua se kjo njësi merret me administrimin dhe mbarëvajtjen e kontratave të stafit akademik. Statuti i AU, për rekrutimin e stafit akademik, kërkon një procedurë konkurimi dhe shpallje fituesi, e cila, në mënyrë të detajuar, parashikohet në nenin 30 të Rregullores së Përgjithshme të IAL-së, të miratuar në 03.05.2017. Për procedurën e rekrutimit, Departamenti i Shkencave Juridike paraqet kërkesën e cila miratohet nga Dekani; më pas Drejtoria e Burimeve Njerëzore shpall vendin vakant në faqen zyrtare të IAL-së. Më pas procedohej me lidhjen e kontratës (nga minutat e takimit me D. B. Njerëzore).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- U rikërkuan tabelat e RVB-së për stafin akademik të Departamentit të Shkencave Juridike pasi kishin pasaktësi.

- U sigurua informacion edhe nga vizita në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Struktura organizative e Albanian University përshin njësitë, organet dhe autoritetet drejtuese të parashikuara nga kuadri ligjor i Arsimit të Lartë.</p> <p>IAL ka 3 Fakultete (njësi kryesore): Fakulteti i Shkencave Mjekësore (me 3 Departamente), Fakulteti i Shkencave Shoqërore (me 4 Departamente) dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (me 3 Departamente).</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërjen e tij 4 Departamente, të cilat janë: Departamenti i Shkencave Juridike (që ofron programin e studimit, objekt vlerësimi); Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative; Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.</p> <p>Departamenti i Shkencave Juridike ka në përbërjen e tij 10 anëtarë si personel akademik efektiv, ku 5 prej tyre kanë gradën shkencore Dr/PhD, 2 prej tyre janë në proces doktorature, 1 prej tyre është MND dhe 2 prej tyre kanë diplomë Msc.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik</p>	<p>Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e Njësisë kryesore dhe Njësive bazë, si dhe drejtuesve të tyre janë të mirëpërcaktuara në aktet kryesore të organizimit dhe funksionimit të IAL: në Statutin e IAL-së (2016), në Rregulloren e</p>

të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Përgjithshme të IAL-së (2017), në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, (2016), në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Departamentit të Shkencave Juridike (2018). Nga takimi dhe bisedat e zhvilluara me përfaqësuesit e Fakultetit dhe Departamentit, u evidentua njohja e këtyre përgjegjësive për realizimin e programit të studimeve. Bazuar në nevojat për personel akademik, njësia bazë (Departamenti i Shkencave Juridike) paraqiste kërkesat dhe njësia kryesore (Fakulteti, nëpërmjet Dekanit) bënte miratimin e tyre. Më pas bëhej shpallja e kërkesës për vend të lirë pune në faqen zyrtare të institucionit (neni 30 i Rregullores së Përgjithshme të IAL-së, të miratuar në 03.05.2017).
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se IAL në vlerësim (Albanian University) është i organizuar në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në funksion të përmbushjes së misionit të tij (të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke ofruar programe studimi). 2. Përzgjedhja, rekrutimi dhe angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë (efektiv) dhe kohë të pjesëshme (me kontratë) bëhet nga Departamenti dhe Fakulteti përkatës, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit. 3. Departamenti i Shkencave Juridike ka në përbërjen e tij 10 anëtarë si personel akademik efektiv, ku 5 prej tyre kanë gradën shkencore Dr./PhD, duke plotësuar kështu kriterin ligjor (neni 25/4 i Ligjit Nr. 80/2015). 	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Nga Departamenti i Shkencave Juridike janë angazhuar personel akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme, me tituj dhe grada të nevojshme për ofrimin e procesit mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor, në programin e studimit objekt vlerësimi.

Për vitin akademik 2017-2018, raporti midis stafit akademik efektiv (kohë të plotë) dhe atij me kontratë (kohë të pjesëshme), në nivel programi studimi Master i Shkencave ishte **6/11**. Pra, për vitin akademik **2017-2018**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhej nga **6 PAE**, me kualifikimin 4 Dr./PhD., dhe 2 MND., si dhe **11 PAK**, me kualifikimin 2 Prof. Dr., 2 Prof. As., 4 Dr./PhD., 1 Dr. proces, 1 Mag., dhe 1 Msc.

Për vitin akademik 2018-2019, ky raport ishte **6/8**. Pra, për vitin akademik **2018-2019**, stafi akademik




i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga **6 PAE**, me kualifikimin 5 Dr., dhe 1 MND., si dhe **8 PAK**, me kualifikimin 2 Prof. Dr., 4 Dr., 1 MND., dhe 1 Msc.

Hartimi i kurrikulës është bërë nga personeli akademik i angazhuar nga Departamenti i Shkencave Juridike. Po kështu, rishikimi i planit mësimor Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” me 3 profile dhe elementëve që përbëjnë strukturën e programit, është hartuar nga grup pedagogësh (sipas evidencës shtesë të paraqitur nga IAL, dokument shtesë nr.63 – “Raport mbi rishikimin e programeve të studimit në AU, për vitin akademik 2018-2019”, faqe 17).

Në total për vitin akademik 2017-2018 ngarkesa totale e mësimdhënies është **1635 orë**, nga të cilat 1305 orë leksione (të konvertuara) dhe 330 orë seminare. Nga përllogaritjet e ngarkesës mësimore, në total sasia e orëve të mbuluara nga stafi akademik efektiv (i brendshëm) në programin Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” me 3 drejtime, për vitin akademik 2017-2018, është **555 orë mësimore**, ndërsa sasia e orëve të mbuluar nga stafi akademik me kontratë (i jashtëm) është **1080 orë mësimore** (orët janë të konvertuara, sikurse paraqiten në dokumentin Nr.73, pas vizitës në institucion – Ngarkesa Mësimore në DSHJ, 2017-2018). Në këto kushte raporti midis orëve mësimore të mbuluar nga stafi i brendshëm dhe atyre të mbuluara nga stafi i jashtëm është **33.9%** me **66.1%**. Ngarkesa e përgjithshme e pedagogëve efektivë (të brendshëm), duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën që ata kanë marrë në programet e tjera që mbulon Departamenti i Shkencave Juridike, varion nga **75 orë mësimore** (norma më e ulët) deri në **412.5 orë mësimore** (norma më e lartë). Ndërsa ngarkesa e përgjithshme e pedagogëve të jashtëm, të angazhuar në këtë program studimi, duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën që ata kanë marrë në programet e tjera që mbulon Departamenti i Shkencave Juridike, varion nga **30 orë mësimore** (norma më e ulët) deri në **480 orë mësimore** (norma më e lartë).

Nga krahasimi i dokumentave shtesë (konkretisht dokumenti Nr. 2 - “Plani mësimor lidhur me personelin akademik përkatës” dhe dokumenti Nr.73 - “Ngarkesa mësimore për semestrin e parë dhe të dytë të vitit akademik 2017-2018”) rezulton se ka një mospërputhje midis stafit akademik të jashtëm. Në dokumenta rezulton si e rekrutuar pedagoge e jashtme MND. R.K, e cila nuk ka marrë ngarkesë mësimore, por ka marrë një tjetër pedagoge e jashtme Msc. L. Rr, e cila nuk rezulton e rekrutuar si pedagoge e jashtme në vitin akademik 2017-2018.

Në total për vitin akademik 2018-2019 ngarkesa totale e mësimdhënies është **1036 orë**, nga të cilat 661 orë leksione, 225 orë seminare dhe 150 orë ushtrime. Sasia e orëve të mbuluar nga stafi akademik efektiv (i brendshëm) në programin “Master i Shkencave në Shkenca Juridike” me 3 drejtime, për vitin akademik 2018-2019, është **720 orë mësimore**, ndërsa sasia e orëve të mbuluar nga stafi akademik me kontratë (jo i brendshëm) është **316 orë mësimore**. Në këto kushte raporti midis orëve mësimore të mbuluar nga stafi i brendshëm dhe atyre të mbuluara nga stafi i jashtëm është **69.5%** me **30.5%** (të dhënat janë marrë nga dokumenti shtesë Nr.8 – “Ngarkesa mësimore për semestrin e parë dhe të dytë të vitit akademik 2018-2019”). Për vitin akademik 2018-2019, ngarkesa e përgjithshme e pedagogëve efektivë (të brendshëm), duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën që ata kanë marrë në programet e tjera që mbulon Departamenti i Shkencave Juridike, varion nga **75 orë mësimore** (norma më e ulët) deri në **442 orë mësimore** (norma më e lartë). Ndërsa ngarkesa e përgjithshme e pedagogëve me kontratë (të jashtëm), të angazhuar në këtë program studimi, duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën që ata kanë marrë në programet e tjera që mbulon Departamenti i Shkencave Juridike, varion nga **15 orë mësimore** (norma më e ulët) deri në **203 orë mësimore** (norma më e lartë).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

Për vitin akademik **2017-2018**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 6 PAE, me kualifikimin 4 Dr./PhD., dhe 2 MND., dhe 11 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr., 2 Prof. As., 4 Dr./PhD., 1 Dr. Proces, 1 Mag., dhe 1 Msc. Personeli akademik i angazhuar gjatë vitit akademik 2017-2018 (PAE + PAK), në programin “Master i Shkencave në Shkenca Juridike” me 3 drejtime paraqitet në tabelën 3 të Anekseve.

Për vitin akademik **2018-2019**, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 6 PAE, me kualifikimin 5 Dr., dhe 1 MND., dhe 8 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr., 4 Dr., 1 MND., dhe 1 Msc. Personeli akademik i angazhuar gjatë vitit akademik 2018-2019 (PAE + PAK), në programin Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” me 3 drejtime paraqitet në tabelën 3 të Anekseve.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Nuk ka.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 4 e Anekseve)

Për vitin akademik **2017-2018**, për programin e studimit në vlerësim, raportet paraqiten si në vijim:

2 Prof. (PAK); 2 Prof. As. (PAK); 8 Dr/PhD (4 PAE/4 PAK); 2 MND (PAE); 1 Dr. Proces (PAK); 1 Mag. (PAK) dhe 1 Msc. (PAK).

Për vitin akademik **2018-2019**, për programin e studimit në vlerësim, raportet paraqiten si në vijim:

2 Prof. (PAK); 9 Dr/PhD (5 PAE/4 PAK); 2 MND (1 PAE/1 PAK) dhe 1 Msc. (PAK).

- Të dhënat sipas seksit

Për vitin akademik 2017-2018, për programin e studimit në vlerësim, janë angazhuar në procesin mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor gjithsej pedagogë të brendshëm 5 femra dhe 1 mashkull dhe pedagogë të jashtëm 9 femra dhe 2 meshkuj.

Për vitin akademik 2018-2019, për programin e studimit në vlerësim, janë angazhuar në procesin mësimdhënës dhe të kërkimit shkencor gjithsej pedagogë të brendshëm 5 femra dhe 1 mashkull dhe pedagogë të jashtëm 7 femra dhe 1 mashkull.

- Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabela 5 e Anekseve)

Për vitin akademik 2017-2018, për programin e studimit në vlerësim, stafi akademik me kontratë (PAK) ka patur këtë moshë: 2 pedagogë të moshës 56-65 vjeç; 3 pedagogë të moshës 46-55 vjeç; 2 pedagogë të moshës 36-45 vjeç; 4 pedagogë të moshës 25-35 vjeç. Ndërsa stafi akademik i brendshëm (PAE) ka patur këtë moshë: 1 pedagogë të moshës 46-55 vjeç; 4 pedagogë të moshës 36-45 vjeç; 1 pedagogë të moshës 25-35 vjeç.

Për vitin akademik 2018-2019, për programin e studimit në vlerësim, stafi akademik me kontratë (PAK) ka patur këtë moshë: 2 pedagogë të moshës 56-65 vjeç; 2 pedagogë të moshës 46-55 vjeç; 2 pedagogë të moshës 36-45 vjeç; 2 pedagogë të moshës 25-35 vjeç. Ndërsa stafi akademik i brendshëm (PAE) ka patur këtë moshë: 5 pedagogë të moshës 36-45 vjeç; 1 pedagogë të moshës 25-35 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Të dy kategoritë e stafit akademik, me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme, punësohen në IAL me kontratë. Kontrata hartohet në mbështetje të dispozitave të Kodit të Punës të RSH dhe Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Kontrata e punës lidhet midis "UFO" shpk (Albania University), në cilësinë e punëdhënësit dhe personit të punësuar si Profesor/Lektor/Asistent Lektor (Punëmarrësit). Kontrata lidhet me afat të pacaktuar për të dy kategoritë, si për personelin akademik efektiv, ashtu dhe atë me kohë të pjesshme.

Sipas vëzhgimit të dosjeve të personelit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore rezultojnë se për të dy kategoritë e personelit përdorej e njëjta kontratë pune. I vetmi dallim parashikohet në nenin 5, pika 1 të Kontratës, ku parashikohet marrëdhënia e punës me "Kohë të Plotë" apo me "Kohë të Pjesshme":

-Për personelin akademik efektiv përdorej Kontratë Pune me afat të pacaktuar me "Kohë të Plotë".

-Për personelin akademik me kontratë përdorej Kontratë Pune me afat të pacaktuar me "Kohë të Pjesshme".

Kontrata plotësohet me ankes-kontratë për çdo semester, ku parashikoheshin lëndët që merr pedagogu dhe ngarkesa e orëve për çdo lëndë. Kontrata parashikonte të drejtat dhe detyrimet midis palëve punëdhënëse dhe punëmarrës.

Dosja e personelit akademik përmbante: ID, CV, Librezë shëndetësore, dokumentacion për kualifikimin akademik (Vendim për doktoraturën, diplomë e shkollës së lartë, listë notash, Diplomë Master Nivel i Dytë, Certifikatë notash etj), librezë e punës, Kontrata e Punës.

Statuti i AU, në nenin 36, pika 5 të tij, për rekrutimin e stafit akademik, kërkon një procedurë konkurimi dhe shpallje fituesi, të cilën i referon Rregullores së Përgjithshme të IAL-së. Procedura e rekrutimit të stafit akademik, në mënyrë të detajuar, parashikohet në nenin 30 të Rregullores së Përgjithshme të IAL-së, të miratuar në 03.05.2017. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, krahasuar me rregullimin e bërë në këtë dispozitë, u konstatua se:

-Departamenti i Shkencave Juridike në fillim të vitit akademik bën kërkesën për staf akademik dhe Dekani e miraton atë. Me shkresën Nr.ekstra, datë 20.09.2017 (shtojcë e RVB, evidencë 2.7) Departamenti i Shkencave Juridike i ka përcjellë Dekanit të Fakultetit kërkesën për:

-nevojat për pedagogë të rinj (të detajuar sipas fushave);

-kriteret e rekrutimit;

-komisionin e vlerësimit të kandidatëve me 5 anëtarë, i drejtuar nga Dekani i Fakultetit.

-Neni 30, pika 3 e Rregullores parashikon që kërkesat i përcillen Rektorit i cili miraton kriteret e pranimit të kandidatëve konkurrues dhe procedurat e rekrutimit. Nuk rezultojnë i dokumentuar respektimi i kësaj pike të rregullores. Nuk u konstatua ndonjë vendim apo shkresë e Rektorit për miratimin e kriterëve të pranimit, psh. në lidhje me titullin apo gradën që duhet të ketë kandidati për çdo rast, apo në lidhje me ekperiencën në mësimdhënie etj. Ndërkohë që sipas RVB (faqe 40) kriteri i parë mbi të cilën mbështetet rekrutimi i kandidatëve për staf akademik është përcaktuar kriteri: "Të kenë së paku gradën shkencore "Doktor" ose PhD", ky kriter nuk rezultojnë të jetë miratuar apo të jetë zbatuar i tillë. Kriteret e rekrutimit të miratuara për stafin akademik të Departamentit të Shkencave Juridike, për vitin 2017-2018 (shkresa Nr.ekstra, datë 20.09.2017, shtojcë e RVB, evidencë 2.7), janë të përgjithshme: a) diplomimi përkatës; b) formimi i përgjithshëm arsimor dhe profesional; c) kualifikime të tjera; d) përvoja pedagogjike; e) zotërimi i aftësive të nevojshme personale për vendin e punës.

-Neni 30, pika 4 e Rregullores parashikon që Fakulteti ngre një komision vlerësimi për nevojat e tij për rekrutim, i cili drejtohet nga Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, një anëtar i personelit akademik me ekperiencë të gjatë, një përfaqësues i Zyrës së Kurrikulës dhe një përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Dekani, me vendimin Nr.2, datë 20.09.2019 (shkresa Nr. 764 Prot. datë 20.09.2017) ka miratuar ngritjen e këtij komisioni vlerësimi (shtojcë e RVB, evidencë 2.7).

-Neni 30, pika 5 dhe 6 e Rregullores parashikon që kandidatët e paraqitur i nënshtrohen një procedure publike konkurimi dhe komisioni vlerëson kandidaturat duke preferuar ato kandidatura që plotësojnë më mirë kriteret e pranimit. Nuk rezulton i dokumentuar respektimi i kësaj dispozite të rregullores. Nuk është hartuar ndonjë tabelë vlerësimi me pikë, referuar kriterëve të pranimit të kandidaturave, për të bërë krahasimin midis kandidaturave të paraqitura. Pra, nuk dokumentohet se si është bërë vlerësimi i 4 kandidatëve të cilët ishin paraqitur (në rastin konkret) për të konkuruar për pozicionin e pedagogut të jashtëm në Departamentin e Shkencave Juridike. Komisioni i vlerësimit të kandidatëve, i ngritur për Departamentin e Shkencave Juridike, ka miratuar një vendim, i cili nuk ka datë dhe as numër protokollit, ku ka shpallur fitues dy kandidatë për Departamentin e Shkencave Juridike si pedagogë të jashtëm dhe një kandidat për rekrutim si pedagog i brendshëm në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes. Ndërkohë që komisionet e vlerësimit për këta dy departamente ishin miratuar të veçantë për secilin departament. Pra, i njëjti komision ka vlerësuar dhe ka shpallur fituesit midis kandidatëve që konkurronin si pedagogë të jashtëm për lëndët e shkencave juridike dhe kandidatëve që konkurronin si pedagogë të brendshëm në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes. Ndërkohë që dhe vlerësimi/pikëzimi i kriterëve dhe renditja e konkurentëve sipas pikëve të grumbulluara, nuk pasqyrohet fare në ndonjë tabelë apo procesverbal, ku të evidentoheshin një për një dokumentat e paraqitura prej kandidatëve dhe pikët e marra prej tyre. Nuk kemi informacion nëse është bërë ndonjë shpallje publike për fituesin, në mënyrë që tu jepej mundësia konkurentëve të pasuksesshëm të ankoheshin për procedurën e rekrutimit. U konstatua që vendi vakant shpallej në faqen zyrtare të IAL-së, si dhe në Zyrën e Punës dhe më pas procedohej me lidhjen e kontratës (nga minutat e takimit me D.B.Njerëzore).

Cilësia e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë

Departamenti i Shkencave Juridike ka angazhuar staf ndihmës/administrativ të cilët ndihmojnë në realizimin e programeve të studimit që ofron ky departament duke asistuar në procesin mësimdhënës dhe kërkimor-shkencor. Për vitin akademik 2017-2018 stafi administrativ përbëhej nga 3 persona, me kualifikimin 1 Dr. proces, 1 Msc., dhe 1 Bsc., ndërsa në vitin akademik 2018-2019, stafi administrativ përbëhet nga 6 persona, me kualifikimin 1 Dr. proces, 4 Msc., dhe 1 Bsc.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Universiteti Privat "Albanian University" angazhon staf akademik në kategoritë Profesor, Lektor dhe Asistent Lektor të cilët sigurojnë realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor shkencor. Stafi akademik është i punësuar me kohë të plotë (i cilësuar si efektiv) dhe me kohë të pjesshme (i cilësuar me kontratë).
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me	

strategjinë për zhvillim të institucionit.	Universiteti Privat “Albanian University” angazhon staf administrativ që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor shkencor. Angazhimi i stafit akademik dhe administrativ është në përputhje me strategjinë e institucionit.
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Hartimi i kurrikulës është bërë nga personeli akademik i angazhuar nga Departamenti i Shkencave Juridike. Po kështu, rishikimi i planit mësimor Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” me 3 profile dhe elementëve që përbëjnë strukturën e programit, është hartuar nga grup pedagogësh.</p> <p>Miratimi i elementëve që përbëjnë strukturën e programit, si dhe ndarja e ngarkesës mësimore është bërë në përputhje me VKM Nr.41, dt.24.01.2018 si dhe me Udhëzimin Nr.15, dt.04.04.2008.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Nuk u konstatua ndonjë vendim apo shkresë e Rektorit për miratimin e kriteve të pranimit. Ndërkohë që sipas RVB, kriteri i parë mbi të cilën mbështetet rekrutimi i kandidatëve për staf akademik është përcaktur kriteri: “Të kenë së paku gradën shkencore “Doktor” ose PhD”, ky kriter nuk rezultoi të jetë miratuar apo të jetë zbatuar i tillë. Nuk është hartuar ndonjë tabelë vlerësimi me pikë, referuar kriteve të pranimit të kandidaturave, për të bërë krahasimin midis kandidaturave të paraqitura. Komisioni i vlerësimit të kandidatëve, i ngritur për Departamentin e Shkencave Juridike, ka miratuar një vendim, ku ka shpallur fitues dy kandidatë për Departamentin e Shkencave Juridike si pedagogë të jashtëm dhe një kandidat për rekrutim si pedagog i brendshëm në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes. Ndërkohë që komisionet e vlerësimit për këta dy departamente ishin miratuar të veçantë për secilin departament. Vlerësimi/pikëzimi i kriteve dhe renditja e konkurrenteve sipas pikëve të grumbulluara, nuk pasqyrohet fare në ndonjë tabelë apo procesverbal. Nuk kemi informacion nëse është bërë ndonjë shpallje publike për fituesin, në mënyrë që tu jepej mundësia konkurrentëve të pasuksesshëm të ankoheshin për procedurën e rekrutimit.</p>

Sa më sipër, grupi i ekspertëve konkludon se IAL nuk ndjek procedura transparente të rekrutimit të personelit akademik, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të AU. Nuk ndiqet një procedurë publike konkurimi e bazuar në pikëzimin e kritereve të pranimit të miratuara paraprakisht. Nuk bëhet renditja e konkurrentëve sipas pikëve të marra dhe shpallja e fituesit.

IAL publikon njoftimet për vendet vakante në faqen zyrtare të IAL dhe tek Zyra e Punës dhe ka një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit.

Raporti midis orëve mësimore të mbuluar nga stafi i brendshëm dhe atyre të mbuluara nga stafi i jashtëm është, për vitin akademik 2017-2018, **33.9% me 66.1%, duke mos u plotësuar kështu kushti i mbulimit të jo më pak të 70% të ngarkesës mësimore nga stafi i brendshëm.** Ndërsa raporti numerik midis stafit akademik efektiv dhe atij me kontratë (kohë të pjesshme) në këtë program studimi, për vitin akademik 2017-2018, është 6/11.

Për vitin akademik 2017-2018, ngarkesa e përgjithshme e pedagogëve të jashtëm, të angazhuar në këtë program studimi, duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën që ata kanë marrë edhe në programet e tjera që mbulon Departamenti i Shkencave juridike, varion nga **30** orë mësimore (norma më e ulët) deri në **480** orë mësimore (norma më e lartë). Ndërsa për pedagogët efektivë (të brendshëm) ngarkesa totale, duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën që ata kanë marrë edhe në programet e tjera që mbulon Departamenti i Shkencave juridike, varion nga **75** orë mësimore (norma më e ulët) deri në **412.5** orë mësimore (norma më e lartë).

Për vitin akademik 2018-2019, raporti midis orëve mësimore të mbuluar nga stafi i brendshëm dhe atyre të mbuluara nga stafi i jashtëm është **69.5% me 30.5%, duke qenë kështu pothuajse i plotësuar kushti i mbulimit të jo më pak të 70% të ngarkesës mësimore nga stafi i brendshëm.** Ndërsa raporti numerik midis stafit akademik efektiv dhe atij me kontratë (kohë të pjesshme) në këtë program studimi, për vitin akademik 2018-2019, është 6/8. Për këtë viti akademik, ngarkesa e përgjithshme e pedagogëve të jashtëm, të

	<p>angazhuar në këtë program studimi, duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën që ata kanë marrë edhe në programet e tjera që mbulon Departamenti i Shkencave juridike, varion nga 15 orë mësimore (norma më e ulët) deri në 203 orë mësimore (norma më e lartë). Ndërsa për pedagogët efektivë (të brendshëm) ngarkesa totale, duke marrë në konsideratë dhe ngarkesën që ata kanë marrë edhe në programet e tjera që mbulon Departamenti i Shkencave juridike, varion nga 75 orë mësimore (norma më e ulët) deri në 442 orë mësimore (norma më e lartë).</p> <p>Nga krahasimi i dokumentave, për vitin akademik 2017-2018, rezulton se ka një mospërputhje midis stafit akademik të jashtëm. Në dokumenta rezulton si e rekrutuar pedagoge e jashtme MND.R.K., e cila nuk ka marrë ngarkesë mësimore, por ka marrë një tjetër pedagoge e jashtme, Msc. L.Rr., e cila nuk rezulton e rekrutuar si pedagoge e jashtme në vitin akademik 2017-2018.</p> <p>Institucioni ndjek procedura të vlerësimit të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik, të cilat zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik me mbështetjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësië.</p>
--	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Juridike ka gradën shkencore “PHD” të fituar në një Universitet perëndimor. Përgjegjësi i Departamentit është dhe Përgjegjës i Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca juridike”.</p> <p>Titullarët e lëndëve në programin e studimeve “Master i Shkencave” (të cilët kanë firmosur syllabuset) mbajnë titullin Prof. dhe Prof.Asoc. Ndërkohë stafi i angazhuar në mësimdhënie në këto lëndë mbajnë kryesisht gradën shkencore “Doktor”, si dhe titullin Prof. dhe Prof. Asociuar. Në vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar në mësimdhënie vetëm 2 pedagogë me diplomë Msc (1 PAE dhe 1 PAK). Në vitin akademik 2018-2019 ka vetëm 1 pedagog me diplomë Msc (PAK) i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani dhe përgjegjësi i departamentit janë të punësuar me kohë të plotë në IAL.</p>
---	---

mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Departamenti ka caktuar një pedagog për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale të studentëve të programit Master i Shkencave.
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Departamenti ka miratuar listën e temave të studentëve të programit Master i Shkencave në Shkenca Juridike, për tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli (listë shtesë e paraqitur pas vizitës në Institucion – dokument nr.62).</p> <p>Nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, si dhe nga sqarimi i dhënë më shkrim nga IAL mbi draft raportin, konkludohet se udhëheqësi i tezës për mbrojtjen e diplomës së studentëve të këtij programi (Master i Shkencave) ka të paktën gradën shkencore “Doktor i shkencave”. Gjithashtu numri maksimal i studentëve të udhëhequr, nuk ishte më i madh se 10 (dhjetë).</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Departamenti ka miratuar listën e temave të studentëve të programit Master i Shkencave në Shkenca Juridike, për tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli (listë shtesë e paraqitur pas vizitës në Institucion – dokument nr.62). Por nuk ka njëlistëku të jenë evidentuar emrat e pedagogëve që udhëheqin studentët. Prandaj është e pamundur për të vlerësuar përmbushjen e këtij kriteri, për sa i përket fushës studimore dhe njohurive teorike të udhëheqësit.</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike nuk janë parashikuar në planin mësimor orë laboratorike.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Shkencave Juridike angazhohen në realizimin e ngarkesës mësimore, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin Master i Shkencave në Shkenca Juridike vlerësohet me orë mësimore. Këto orë mësimore janë të shpërndara në orë mësimore në auditor me leksione/seminare/ushtime dhe në orë pune individuale. Në total për vitin akademik 2017-2018 ngarkesa totale e mësimdhënies është 1635 orë, nga të cilat 1305 orë leksione (të konvertuara) dhe 330 orë seminare. Në total për vitin akademik 2018-2019 ngarkesa totale e mësimdhënies është 1036 orë, nga të cilat 661 orë leksione, 225 orë seminare dhe 150 orë ushtime.</p>
--	--

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Departamenti dhe Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të dhëna për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program.</p> <p>Departamenti disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik si dhe ngarkesën për çdo semestër të secilit pedagog (PAE dhe PAK).</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore publikon shpalljen e vendit të lirë të punës. Kriteret e pranimit (rekrutimit) nuk janë miratuar ashtu sikurse përcaktohen në aktet e brendshme normative dhe nuk janë respektuar procedurat e parashikuara në Rregulloren për rekrutimin e personelit akademik.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. IAL angazhon në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Juridike" personelin akademik (PAE dhe PAK) që përgjithësisht plotëson kriteret për titujt dhe gradat për mësimdhënie dhe kërkim shkencor në këtë program studimi. Pedagogët mbajnë kryesisht gradën shkencore "Doktor", si dhe titullin Prof. dhe Prof. Asociuar. Në vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar në mësimdhënie vetëm 2 pedagogë me diplomë Msc (1 PAE dhe 1 PAK). Në vitin akademik 2018-2019 ka vetëm 1 pedagog me diplomë Msc (PAK) i angazhuar në këtë program studimi.
2. Për vitin akademik 2017-2018, raporti midis orëve mësimore të mbuluar nga stafi i brendshëm dhe atyre të mbuluara nga stafi i jashtëm është **33.9%** me **66.1%**. Ngarkesa e përgjithshme e pedagogëve të jashtëm (edhe në programet e tjera), varion nga **30** deri në **480** orë mësimore. Ndërsa për pedagogët efektivë ngarkesa totale (edhe në programet e tjera), varion nga **75** deri në **412.5** orë mësimore. Për vitin akademik 2018-2019, personeli akademik me kohë të plotë mbulon pothuajse **70%** (**69.5%**) të ngarkesës mësimore. Ngarkesa e përgjithshme e pedagogëve të jashtëm (edhe në programet e tjera), varion nga **15** deri në **203** orë mësimore, ndërsa për pedagogët efektivë ngarkesa totale varion nga **75** deri në **442** orë

mësimore. Fusha e ekspertizës së personelit akademik, përgjithësisht, përputhet me lëndët që ata mbulojnë.

3. Personeli akademik me kohë të plotë merr pjesë në hartimin e syllabuese dhe rishikimit të programit.
4. IAL angazhon stafin akademik me tituj dhe grada në mentorimin e studentëve për hartimin e tezave të diplomave.
5. IAL nuk ndjek procedura publike transparente konkurimi për rekrutimine personelit akademik, të bazuara në vlerësimin/pikëzimin e kriterëve të pranimit, të miratuara paraprakisht.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Departamenti i Shkencave Juridike e zhvillon procesin akademik bashkë me 3 departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në godinën qendrore, e cila ndodhet në Bulevardin "Zogu I", me një sipërfaqe 3.996 m² (sipas informacionit të pasqyruar në RVB). Kjo godinë ka qenë ekzistuese dhe dhe të gjitha ambientet e saj janë rikonstruktuar, duke u adoptuar në salla leksionesh, seminaresh dhe laboratorësh.

Nga vizita në institucion u konstatua se këto salla leksionesh dhe seminaresh për programin e studimit "Master i Shkencave" në "Shkenca Juridike" ishin pozicionuar kryesisht nën katin përdhe (nën nivelin e tokës) dhe ishin të aksesueshme normalisht me shkallë të gjera. Sallat ishin të pajisura me të gjithë pajisjet dhe aksesorët e nevojshëm për zhvillimin e mësimin, me video-projektorë dhe flipcharte. Këto salla janë të mjaftueshme për të ofruar procesin mësimor ndaj studentëve të këtij programi studimi, duke marrë në konsideratë numrin relativisht të vogël të studentëve të regjistruar për dy vitet akademike. (duke iu referuar të dhënave të evidencave të RVB dhe verifikimit nga vizita në institucion rezultoi se: profili "E drejtë publike administrative", për vitin 2017-2018 - 22 studentë të regjistruar, për vitin 2018-2019 - 7 studentë të regjistruar; profili "E drejtë Penale", për vitin 2017-2018 - 19 studentë të regjistruar, për vitin 2018-2019 - 44 studentë të regjistruar; profili "E drejtë Private", për vitin 2017-2018 - 24 studentë të regjistruar, për vitin 2018-2019 - 24 studentë të regjistruar).

Problemi i konstatuar nga vizita në institucion ishte ajrimi i këtyre sallave dhe deri diku edhe ndriçimi. Duke qenë nën nivelin e tokës sallat e leksioneve dhe seminareve ku zhvillohej mësim për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Juridike" ishin pa dritare. Sistemi i kondicionimit, në gjykimin tonë, nuk arrinte të siguronte ajrim të bollshëm për të gjithë studentët sipas kapacitetit që ofronin këto ambiente. Në momentin e vizitës, në këto salla, ajri ishte shumë i rëndë. Po kështu edhe ndriçimi i sallave, në mungesë të dritareve linte për të dëshiruar.

Biblioteka ishte e pajisur me tavolina pune dhe me kënd leximi. Ajo dispononte një kënd të veçantë me librat e fushës së të drejtës, ku u konstatuan disa nga librat që përfshihen në literaturën e paraqitur në syllabuset e lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Juridike". Biblioteka ishte e aksesueshme për studentë dhe pedagogë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, si dhe në fundjavë nga ora 08:00 deri në orën 14:00. Nga Departamenti i Shkencave Juridike bëhen kërkesa për shtim të titujve të librave të fushës së të drejtës, në bibliotekën e fakultetit (Evidencë Nr.4.3.A, dokument

Nr.31, i paraqitur nga IAL). Shërbimi i fotokopjes, që ndodhet në bibliotekën e universitetit mund të përdoret nga studentët dhe pedagogët.

Për të gjithë studentët e AU ishte lehtësisht e aksesueshme 24 orë biblioteka online QUESTIA, që ishte një veçori e infrastrukturës universitare të Albanian University. Biblioteka online ishte funksionale në momentin e kryerjes së vizitës në institucion për kërkimin dhe gjetjen e librave dhe artikujve shkencorë. Kjo bibliotekë online (sipas informacionit të RVB) përmban 83.000 libra akademikë dhe mbi 10 milion artikuj shkencorë.

Laboratori i informatikës është në dispozicion të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, pra edhe të Departamentit të Shkencave Juridike.

Salla e konferencave ishte e pajisur me të gjithë pajisjet e nevojshme për të siguruar realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare.

OPTIME është revista shkencore e AU, ku publikohen të gjitha punimet shkencore, në kuadër të përmbushjes së kërkesave për kërkime dhe botim shkencore në dispozicion të stafit akademik dhe të studentëve.

Në funksion të shpłodhjes dhe relaksimit të studentëve është edhe një mjedis kafeteri/fast food në të njëjtën ndërtesë ku ndodhet Fakulteti i Shkencave Shoqërore.

Godina kishte në katin e parë dhe një zyrë (post) informacioni që mundëson informimin e çdo personi të interesuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (Tabela 6 e Aneksëve):

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj.
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Të gjitha ambjentet e mësipërme ishin të mjaftueshme dhe të pajisura me bazën materiale të nevojshme. Problemi i vetëm, i konstatuar nga vizita në institucion, për sallat e leksioneve dhe seminareve ishte ajrimi i këtyre sallave dhe deri diku edhe ndriçimi, që në gjykimin tonë duhet të ishte më cilësor.

Mjediset për stafin (Tabela 6 e Aneksëve):

- Mjediset për Dekanin/ kancelarin



- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Mjedise sa më sipër kishte dhe ato ishin të mjaftueshme dhe ta pajisura më bazën materiale të nevojshme.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” ka në dispozicion të tij disa godina. Godina ku zhvillon aktivitetin e tij Departamenti i Shkencave Juridike, për të gjithë programet e studimit që ofron ky Departament, përfshirë programin në vlerësim, ndodhet në qendër të qytetit të Tiranës, me një sipërfaqe prej 3.996 m².</p> <p>Kontrata e qerasëeshtë lidhur midis shoqërisë “UFO” SH.P.K dhe qeradhënësve për 20 vjet, për periudhën 2006-2026. Provohet kështu që këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.</p> <p>Praktikat e studentëve të këtij programi studimi nuk ofrohen në mjediset e këtij fakulteti.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve</p>	<p>Në syllabuse janë paraqitur qartësisht literatura e detyruar për lëndën përkatëse në shqip, që është dhe literatura e përdorur gjerësisht për lëndët e së drejtës nga Universitetet Shqiptare. Gjithashtu pasqyrohet dhe literatura e rekomanduar, ku për lëndët e këtij programi janë kryesisht Kodet dhe Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë si dhe ato të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, pasqyrohet në syllabuse edhe literatura në gjuhë të huaj.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Shoqërore disponon një kënd të posaçëm edhe për librat e fushës së të drejtës, ku evidentohet edhe titujt e paraqitur në literaturën e detyrueshme të syllabuseve. Biblioteka online “QUESTIA” ofron për të gjithë studentët, por edhe për pedagogët, mundësinë për të aksesuar literaturën e nevojshme të huaj, qoftë për procesin mësimdhënës, ashtu dhe atë kërkimor-shkencor. Po kështu edhe revista “Optime”,</p>

dhe nevojat e studentëve.	<p>nëpërmjet botimeve periodike, është një mundësi për tu njohur me literaturën kontemporane të fushës së drejtës.</p> <p>Biblioteka, biblioteka online dhe revista periodike "Optime" krijojnë mundësi për studentët për realizimin me sukses të programit të studimit, si dhe të projektit kërkimor shkencor për përgatitjen e tezës.</p> <p>Departamenti harton një plan të titujve të librave që duhet të shtohen në bibliotekën e Fakultetit për çdo vit akademik.</p> <p>Biblioteka ka orare të shërbimit jo plotësisht në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p> <p>Biblioteka ishte e aksesueshme për studentë dhe pedagogë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, si dhe në fundjavë nga ora 08:00 deri në orën 14:00. Ndërkohë që orari i zhvillimit të procesit mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Juridike", është kryesisht i fokusuar mbasditë në ditët e javës dhe paradite në fundjavë.</p>
---------------------------	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion salla leksioni dhe seminaresh, zyra dhe ambjente të tjera për të siguruar realizimin e programit të studimit (Master Shkencor në Shkenca Juridike), duke marrë në konsideratë edhe faktin se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është relativisht i vogël.</p> <p>Sallat janë të pajisura me tryeza pune dhe të gjithë pajisjet dhe aksesoret e nevojshëm për zhvillimin e mësimimit, me video-projektorë dhe flipcharte.</p> <p>Në dispozicion të studentëve të Departamentit të Shkencave Juridike, sikurse dhe të gjithë studentëve të tjerë të fakultetit është laborator i informatikës me kapacitet për 30 persona.</p> <p>Problemi i vetëm, i konstatuar nga vizita në institucion, në gjykimin e grupit të ekspertëve, ishte ajrimi i pa-mjaftueshëm i këtyre sallave dhe deri diku edhe ndriçimi. Duke qenë në nivelin e tokës sallat e leksioneve dhe seminareve ku zhvillohej mësim për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Juridike" ishin pa dritare. Sistemi i kondicionimit, në gjykimin tonë, nuk arrinte të siguronte ajrim të bollshëm për të gjithë studentët sipas kapacitetit që ofronin këto ambjente. Në momentin e vizitës, në këto salla, ajri ishte shumë</p>
--	---

i rëndë. Po kështu edhe ndriçimi i sallave, në mungesë të dritareve linte për të dëshiruar.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Në aspektin sasior, infrastruktura e godinës ku zhvillohen aktivitetet e programit mësimor Master i Shkencave në "Shkenca Juridike" ishte e mjaftueshme në sipërfaqe dhe mjaftueshmërisht e pajisur me pajisjet dhe mjetet e nevojshme për ofrimin ndaj studentëve të këtij programi studimi.
2. Në aspektin cilësor, në gjykimin tonë, në sallat e leksioneve dhe të seminareve ajrimi ishte i pamjaftueshëm dhe deri diku edhe ndriçimi i tyre. Kjo për arsyen se sallat e leksioneve dhe seminareve ku zhvillohej mësim për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Juridike", duke qenë të pozicionuara nën katin bazë (katin përdhe), ishin pa dritare. Gjykojmë se duhet përmirësuar sistemi i kondicionimit dhe ndriçimi i këtyre sallave.
3. Biblioteka e fakultetit, bibliotela online "QUESTIA" dhe revista periodike "Optime" ofrojnë për studentët dhe stafin akademik literaturë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, duke krijuar mundësi për realizimin me sukses të programit të studimit, si dhe të kërkimit shkencor.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Statuti i Albanian University parashikon statusin juridik të këtij Institucioni Jopublik të Arsimit të Lartë. Në paragrafin 1 dhe 3 të nenit 1 të Statusit të AU parashikohet se: "*Albanian University (këtu e në vazhdim AU) është person juridik, i organizuar si Institucion Jopublik i Arsimit të Lartë, me statusin e Universitetit që financohet nga burimet e veta të brendshme dhe burime të tjera të ligjshme....Veprimtaria e Albanian University bazohet në Kushtetutën e RSH, ligjin nr.80/2015, në ligjin "Për Shoqëritë Tregtare", në këtë statut, si dhe në Rregulloret që miratohen në zbatim të tij".* Kjo dispozitë e Statutit të AU nuk parashikon natyrën e veprimtarisë së Albanian University, nëse kjo veprimtari është **fitimprurëse** apo **jo-fitimprurëse**, ndërkohë që, në gjykimin tonë, duhet ta bënte këtë rregullim në zbatim të dispozitës së nenit 17/3 të Ligjit Nr.80/2015, ku parashikohet se: "*Institucionet jopublike të arsimit të lartë janë persona juridikë privatë. Veprimtaria që ato zhvillojnë mund të jetë fitimprurëse ose jofitimprurëse*". Në asnjë prej akteve nënligjore që normojnë veprimtarinë e Albanian University (Statut, Rregullore) nuk bëhet një parashikim i tillë, nëse aktiviteti i këtij Institucioni Jopublik të Arsimit të Lartë është apo nuk është fitimprurës. Gjithashtu në RVB dhe në anekset e RVB-së nuk është përfshirë ndonjë informacion, ku mund të gjykohej mbi natyrën e veprimtarisë së Albanian University, fitimprurëse apo jo-fitimprurëse. I vetmi parashikim që bën Statuti i AU, është ai që veprimtaria e Albanian University bazohet edhe në ligjin "Për Shoqëritë Tregtare". Veprimtaria e Albanian University është pjesë e aktivitetit të një shoqërie tregtare, që është shoqëria tregtare "UFO" sh.p.k, objekti i aktivitetit të së cilës përfshin *inter alia*: "Aktivitet në fushën e arsimit 9 - vjeçar, të mesëm dhe të lartë, universitar dhe pasuniversitar" (të dhënat janë marrë

nga të dhënat publike të Ekstraktit të QKR).

Institucioni, nëpërmjet zyrës së financës, harton një raport financiar për çdo vit kalendarik (i cili shoqëron Bilancin/Pasqyrat Financiare vjetore), të hartuar sipas standardeve përkatëse dhe të certifikuar me ekspertë të jashtëm. Raportipërbantë dhëna të hollësishme për të gjitha të ardhurat e mundshme (si të ardhurat nga tarifat e shkollimit) si dhe për të gjitha shpenzimet (shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj).

Burimet financiare të Albanian University për vitin 2017-2018 dhe vitin akademik 2018-2019, për të ofruar programin e studimit në vlerësim, janë deklaruar se janë siguruar vetëm nga **tarifat e shkollimit** të studentëve. Të vetmet të ardhura të siguruar për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”, të cilat përdoren për mbulimin e shpenzimeve të këtij programi, janë deklaruar në tabelën 7 të Aneksëve.

Aktivitetet e tjera, sipas evidencës së paraqitur në RVB, nuk rezultojnë të kenë siguruar të ardhura për institucionin. Ndërkohë që vetë institucioni i referohet aktivitetit tregtar të ofruar në mjediset e Fakultetit të Shkencave Shoqërore (kafeteri/fast food). Nga verifikimi i kryer gjatë vizitës në institucion, rezultojnë se në funksion të shpërndarjes dhe relaksimit të studentëve është edhe një mjedis kafeteri/fast food në të njëjtën ndërtesë ku ndodhet Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Por ky aktivitet tregtar nuk evidencohet si aktivitet që siguron të ardhura për institucionin.

Sipas informacionit në RVB, studenti në këtë program studimi paguan vetëm tarifën e programit të studimit (tarifën e shkollimit) dhe nuk paguan asnjë tarifë tjetër shtesë. Sipas përkufizimit që bën neni 6 i ligjit Nr.80/2015, “Tarifa e shkollimit” është vlera monetare që paguan studentin për ndjekjen e një programi studimi pranë një institucioni të arsimit të lartë, ndërsa “Tarifa e regjistrimit” është vlera monetare që paguan studentin për t’u regjistruar në një program studimi. *Tarifa e studimit* përfshin *tarifën e regjistrimit* dhe *tarifën e shkollimit* (neni 6, pika 31 e ligjit nr.80/2015). Albanian University i ka përjashtuar të gjithë studentët e saj nga **tarifa e regjistrimit** sepse neni 73 i Statutit të AU parashikon se “Tarifa e studimeve përbëhet nga tarifa e shkollimit”. Nga verifikimi me zgjedhje i dosjeve të studentëve, u konstatua se në dosje administrohej vetëm **dokumenti i pagesës së tarifës së shkollimit**. Nuk u konstatua që studentin të paguajë tarifa të tjera, përveç tarifës së regjistrimit që është përjashtuar nga statuti, siç mund të jetë “Tarifa e aplikimit” (vlera monetare që paguan studentin për aplikim në një program studimi – neni 6/27 i ligjit nr.80/2015), apo “Tarifa e konkurrimit” (vlera monetare që paguan studentin për të konkurruar pranë institucionit të arsimit të lartë për të fituar në një program studimi, në ato raste kur institucioni parashikon zhvillimin e konkursit neni 6/28 i Ligjit Nr.80/2015).

Referuar dispozitave të Statutit të IAL, neni 73, niveli i tarifave të studimit (shkollimit) propozohen nga Senati dhe miratohen nga Bordi i Administrimit. Ky i fundit miraton gjithashtu edhe kategoritë sociale që përfitojnë bursa studimi. Në RVB apo në anekset e saj nuk pasqyrohet vendimi i Bordit të Administrimit (numri dhe data e tij) për miratimin e nivelit të tarifës së studimit që paguan studentin dhe numri i kësteve të kësaj tarife. Gjykojmë se një gjë e tillë duhet të ishte bërë për efekt transparence.

Të ardhurat financiare regjistrohen, përpunohen dhe auditohen bazuar në një numër unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Ky është parashikimi i nenit 22/1 të Statutit të IAL-së. Po sipas këtij neni (neni 22/3), Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 anëtarë, ku 3 prej tyre janë personel akademik të zgjedhur nga Senati Akademik dhe 4 anëtarë janë përfaqësues të Shoqërisë Tregtare “UFO” shpk (administratori dhe 3 anëtarë të tjerë të

zgjedhur nga administratori).

Bazuar në Statutin e Albanian University (neni 13) Institucioni (Albanian University) ka njëzryrë auditimi të brendshëm, e cila është pjesë përbërëse e zyrës së financës. Në dokumentacionin e paraqitura nga IAL (RVB dhe anekset) flitet vetëm për raportin vjetor të auditimit të kryer nga një ekspert kontabël i miratuar, i cili i referohet bilancit vjetor. Por nuk rezulton të jetë evidentuar apo të paktën të jetë përmendur ndonjë raport i hartuar nga struktura e auditit të brendshëm, për eficientë e përdorimit të të ardhurave nga IAL në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të IAL-së, që është detyra themelore e kësaj zyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- **Tarifat për dhe gjatë shkollimit**
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Të gjitha të ardhurat për këtë program studimi, sipas informacionit të paraqitur nga IAL, rezulton të jenë siguruar vetëm nga "Tarifat për dhe gjatë shkollimit". Të gjithë zërat e tjerë të të ardhurave paraqiten me 0 lekë.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Të ardhurat e siguruar nga tarifat e studimit përdoren për mbulimin e shpenzimeve që nevojiten për programin e studimit si paga, sigurime, honorare për mësimdhënie, shpenzime operative për Departamentin etj. Kostoja për një student në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Juridike" rezulton të jetë 130.000 lekë (sipas informacionit të paraqitur në RVB). Kjo kosto për student nuk është e analizuar në mënyrë të detajuar, pra nuk pasqyrohen në detaje shpenzimet për paga, sigurime, kosto operative etj. Në RVB apo në anekset e saj duhet të ishin pasqyruar në mënyrë të detajuar analizimi i kostove për një student në lekë dhe në përqindje, për këtë program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Institucioni ka një raport financiar, që shoqëron Pasqyrat Financiare për çdo vit kalendarik, të hartuar dhe certifikuar me ekspertë të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative, etj.</p> <p>Burimet financiare të Institucionit Albanian University për vitin 2017-2018 dhe vitin akademik 2018-2019, për të ofruar programin e studimit Master Shkencor në “Shkenca Juridike” janë deklaruar vetëm të ardhurat nga tarifat e shkollimit të studentëve. Asnjë aktivitet tjetër nuk deklarohet se siguron të ardhura për këtë program studimi. Ndërkohë që në godinën e Fakultetit të Shkencave Shoqërore funksionon një kafeteri/fast food i cili ishte aktiv dhe duhet të sigurojë të ardhura. Por këto të ardhura nuk janë evidentuar si të ardhura për Institucionin.</p> <p>Në RVB apo në anekset e saj nuk pasqyrohet vendimi i Bordit të Administrimit (nr. dhe data e tij) për miratimin e nivelit të tarifës së studimit që paguan studenti dhe numri i kësteve të kësaj tarife.</p> <p>RVB evidenton vetëm raportin vjetor të auditimit të jashtëm, që auditon bilancin vjetor, por nuk evidenton raportet e auditimit të brendshëm nga zyra e auditimit të brendshëm të IAL, për eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga IAL, në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave. Në këto kushte nuk mund të gjykohet nëse plotësohet kriteri: “Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh”.</p>
<p>Standardi VL1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Kostoja për student, në Masterin Shkencor në Shkenca Juridike, e deklaruar nga IAL, është 130.000 lekë për 1 vit akademik. Kjo kosto nuk është e analizuar në mënyrë të detajuar, pra nuk pasqyrohen në detaje shpenzimet për paga, sigurime, kosto operative etj. Në RVB apo në anekset e saj duhet të ishin pasqyruar në mënyrë të detajuar analizimi i kostove për një student në lekë dhe në përqindje, për këtë program studimi.</p>

IAL nuk harton një raport të detajuar me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka një raport financiar, që shoqëron Pasqyrat Financiare për çdo vit kalendarik, ku pasqyrohen të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe shpenzimet e kryera.
2. Gjykojmë se në dokumentat e IAL-së (RVB dhe anekset) duhet të bëhet transparent vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin e tarifës së studimit, apo për miratimin e kategorive të studentëve që përfitojnë bursa studimi.
3. IAL nuk harton një raport të detajuar me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve.
4. Nuk ka të dhëna në dokumentat e IAL-së (RVB dhe ankeset) mbi Raportete Auditimit të Brendshëm, nga struktura e brendshme përkatëse që ekziston në IAL, në lidhje me eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në AU konsiston në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional. Detyrat dhe kompetencat e NjSBC-së dhe Komisionit përcaktohen shprehimisht në Statutin e AU (**Evidencë 2.1, Kreu II, neni 66 dhe 67**). Funksionet dhe detyrat e NjSBC përcaktohen më në detaje në Rregulloren e Brendshme të Universitetit (**Evidencë 1.3, neni 14**). Në mënyrë të përmbledhur, NjSBC ka për detyrë të hartojë dhe paraqesë në Senatin Akademik një raport vjetor ku përfshihen të dhëna për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, vlerësimin e tyre, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ, si dhe rekomandime për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësim Institucional, NjSBC harton politikat e vetëvlerësimit dhe mundëson hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese.

Me Vendim të Senatit Akademik Nr. 157/3, dt. 08/09/2016, janë miruar dhe njësitë bazë të NjSBC (**Evidencë 6.1**). Këto njësi funksionojnë në nivel Departamenti dhe kanë për detyrë të analizojnë dhe vlerësojnë programet mësimore, literaturën dhe format e vlerësimit. Gjatë vizitës në IAL rezultoi se kjo analizë bëhet në fillim të çdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies dhe në përfundim të tij. Analiza dhe vlerësimi bazohen në anketimet e studentëve, raporteve semestrale dhe vjetore si dhe rezultateve të arritura nga studentët. NjSBC ka akses te palimituar në këto të dhëna. Një tjetër burim të dhënash për NjSBC është dhe sekretaria mësimore. NjSBC ka akses në të gjitha të dhënat e IAL.

Përbërja e NJSBC paraqitet në tabelën 8 të Anekseve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

Janë kryer anketime për semestrin e parë dhe të dytë të vitit akademik 2017-2018, si dhe për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita në IAL rezulton se në semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019 janë anketuar 12 studentë në vit të parë dhe 8 studentë në vit të dytë. Numri i studentëve të anketuar në vitin akademik 2017-2018 nuk del i qartë duke qenë se të dhënat tabelore nuk janë ndarë për vit siç është bërë në simestrin e parë të vitit akademik 2018-2019. Megjithatë, mund të thuhet që për 6 pedagogë janë anketuar 7 studentë, për një pedagog janë anketuar 5 studentë, për dy pedagogë janë anketuar 8 studentë, për një pedagog janë anketuar 6 studentë dhe për tre pedagogë janë anketuar 10 studentë. Kjo lidhet edhe me pjesëmarrjen e studentëve në lëndë të caktuara. Të gjitha anketimet janë përpunuar. Si në raportin vjetor të vitit akademik 2017-2018 ashtu edhe në raportin e semestrit të parë të vitit akademik 2018-2019 evidentohen të njëjtat probleme, që kanë të bëjnë me infrastukturën, penalizimin për shkak të mungesave, objektivitetin në vlerësimin e studentëve, mungesën e organizimit të aktiviteteve ekstrakurrikulare, etj.

Raportet vjetore apo semestrale nuk përmbajnë një seksion të veçantë sa i përket hapave të mëtejshëm. Konstatimi i problemeve duket të jetë formal, kjo dhe për vetë faktin që në të tre raportet e paraqitura nga IAL identifikohen të njëjtat probleme nga studentët e anketuar.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë zë një vend të veçantë në Planin Strategjik për Zhvillim Institucional (**Evidencë 1.4, fq 17**).Njësia e Sigurisë së Brendshme të Cilësisë (NJSBC) kryen periodikisht vlerësimin e brendshëm të cilësisë bazuar në standardet shtetërore të cilësisë, Ligjin e Arsimit të Lartë si dhe udhëzimeve të ASCAL. Ajo ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e IAL. Qëllimi bazë i NJSBC është të mbështesë dhe të sigurojë cilësinë në të gjitha nivelet e funksionimit të IAL.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBC funksionon si njësi qendrore në nivel IAL ndërsa çdo departament ka njësinë bazë të sigurimit të cilësisë. Gjatë vizitës në IAL rezultoi se NJSBC dhe Grupi i Sigurimit të Cilësisë (i ngritur nga njësia bazë) të Departamentit të Shkencave Juridike bashkëpunojnë ngushtë për hartimin e raporteve semestrale dhe vjetore ku përfshihen të dhëna të detajuara për cilësinë e programeve të ofruara nga ky Departament.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimi kryhet nëpërmjet raportit semestral dhe raportit vjetor të hartuara nga njësia bazë. Raportet evidentojnë problemet e hasura si dhe ecurinë e programit mësimor. Megjithatë nuk del qartë

nga raportet se çfarë hapash janë ndërmarrë për adresimin e problemeve të identifikuar, sidomos, ato të identifikuar nga anketimi i studentëve. Nga analiza e këtyre raporteve (**Evidencë 6.2 dhe Dokumenti 11.1 dhe 11.2, të dërguar mbas vizitës në IAL**) rezultojnë se të dhënat e DVV për këtë tregues janë të sakta.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Plani Strategjik për Zhvillim Institucional (**Evidencë 1.4, fq 17**) përcakton objektivat e NjSBC. Statuti i AU përcakton më në detaje kompetencat e NjSBC dhe procedurat që kjo njësi duhet të ndjekë (**Evidencë 2.1**). Raportet semestrale dhe vjetore të hartuara nga njësi bazë përmbajnë të dhëna të detajuara të vetëvlerësimit, analizë SËOT dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë. Këto raporte i përcillen NjSBC e cila harton raportin e saj. Nga vizita në IAL rezultojnë që ky raport i përcillet Rektoratit, i cili së bashku me Senatën Akademik harton një raport tjetër që i përcillet MASR. Ngritja e NjSBC dhe e njësisë bazë, si dhe raportet e hartuara prej tyre, janë një tregues pozitiv i angazhimit të IAL në hartimin e politikave të përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimit periodik. Megjithatë, raportet e hartuara ngelen në nivel rekomandimesh dhe janë formale. Nga vizita në IAL dhe nga analiza e raporteve, rezultojnë që nuk ka një reflektim nëse rekomandimet e mëparshme janë përmbushur (**Evidencë 6.2 dhe Dokumenti 11.1 dhe 11.2, të dërguar mbas vizitës në IAL**).

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare</p>	<p>Vetëvlerësimi kryhet nëpërmjet raporteve semestrale dhe vjetore të hartuara nga njësi bazë. Këto bazohen në të dhëna sasiore rreth rezultateve të studentëve (kalueshmëria), notat mesatare, rezultatet e anketave të studentëve, etj (Evidencë 6.2 dhe Dokumenti 11.1 dhe 11.2, të dërguar mbas vizitës në IAL).</p> <p>Raportet, të cilat përmbajnë rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet për përmirësim të cilësisë, publikohen në faqen e internetit të AU. Rubrika e fundit e raporteve është analiza SEOT dhe analiza krahasimore për ndryshimet dhe ecurinë e të dhënave të shqyrtuara (masat e marra për adresimin e pikave të dobëta). Megjithatë, në këtë rubrikë gjendet vetëm analiza SWOT dhe rekomandime për të ardhmen. Analiza krahasimore mungon dhe nuk ka një reflektim rreth mangësive të konstatuara në raportin semestral ose në raportin vjetor të mëparshëm dhe nuk del qartë se si janë adresuar pikat e dobëta.</p> <p>Metodat e përdorura nga NjSBC për kryerjen e</p>

<p>(p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>vlerësimit janë të tërthorta dhe të drejtëpërdrejta. Metodatat e tërthorta konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorë të studentëve dy herë në vit (Evidencë 3.7.) - Fokus grupe (në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimëdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj (Evidencë 3.8.) <p>Nga vizita në IAL rezulton se metodatat e drejtëpërdrejta konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin me nota dhe pikë në provime; - Teste paraprake dhe përfundimtare; - Detyra kursi, individuale ose në grup; - Pjesëmarrje aktive në leksione dhe seminare; - Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve.
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Raporti vjetor i vetëvlerësimit publikohet në faqen zyrtare të internetit të AU. Ky është i vetmi informacion i publikuar në lidhje me vlerësimin e brendshëm.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në përfundim të vitit akademik hartohet një analizë vjetore në IAL. Kjo analizë përmban informacione të detajuara mbi ecurinë e programeve mësimore, rishikimin e programeve, arritjen e objektivave strategjike, etj. Analiza miratohet nga Senati Akademik dhe publikohet në faqen zyrtare të AU (https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/)</p> <p>Plani Strategjik për Zhvillim Institucional (Evidencë 1.4, fq 7) përmban një sërë objektivash strategjike në lidhje me përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

AU ka kaluar pozitivisht akreditimin institucional me kohëzgjatje 2 (dy) vjeçare me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 90, dt. 20/10/2017.

IAL ka ngritur NjSBC dhe njësitë bazë, për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Detyrat, kompetencat dhe procedurat që duhet të ndjekin NjSBC dhe njësitë bazë janë përcaktuar në Statutin e AU (**Evidencë 2.1**).

Nga vizita ne IAL rezultoi se programet e studimeve dhe syllabuset rishikohen çdo fillim viti akademik nga grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë. Rishikimi i programeve ka për qëllim përditësimin e literaturës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore. Rishikimi i programeve dhe syllabuseve realizohet në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Mësimin dhe Kurrikulat.

Nga vizita në IAL rezultoi gjithashtu se në fillim të çdo viti akademik, në javët orientuese studentët dhe stafi akademik ndërgjegjësohen mbi rëndësinë e vetëvlerësimit.

Përmirësimi i cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore përbën një nga objektivat strategjike të AU (**Evidencë 1.4, fq 7**).

Konkluzionet e vlerësimit:

1. IAL ka ngritur NjSBC dhe njësitë bazë, për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Vetëvlerësimi kryhet nëpërmjet raporteve semestrale dhe vjetore të hartuara nga njësia bazë.
2. Analiza krahasimore mungon dhe nuk ka një reflektim rreth mangësive të konstatuara në raportin semestral ose në raportin vjetor të mëparshëm dhe nuk del qartë se si janë adresuar pikat e dobëta.
3. Metodatat e përdorura nga NjSBC për kryerjen e vlerësimit janë të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Raporti vjetor i vetëvlerësimit publikohet në faqen zyrtare të internetit të AU. Në përfundim të vitit akademik hartohet një analizë vjetore në IAL.
4. Plani Strategjik për Zhvillim Institucional përmban një sërë objektivash strategjike në lidhje me përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.
5. Programet e studimeve dhe syllabuset rishikohen çdo fillim viti akademik nga grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni dhe objektivi i programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”, me drejtime: “E Drejtë Publike dhe Administrative”; “E Drejtë Private”; “E Drejtë Penale”, që ofrohet nga AU, janë përcaktuar qartë në Rregulloren e Programit (**Evidencë 1.1, Neni 4; Evidencë 1.2, fq 2**). Misioni kryesor i programit përputhet me atë të Departamentit të Shkencave Juridike dhe ky mision është të përgatisë profesionistë të aftë si nga pikëpamja teorike ashtu dhe nga ana praktike, duke i pajisur studentët me njohuri themelore në shkencat juridike, kryesisht në fushën private, publike dhe atë penale, si dhe duke i pajisur ata me aftësi, zotësi dhe shprehje të formimit juridik. Objektivi i përgjithshëm i Programit është formimi i plotë i studentëve në fushën ligjore, i cili paraqitet i domosdoshëm për të vepruar me kompetencë në realitetin kompleks aktual juridik. Sipas objektivave specifike të Programit, në përfundim të tij, studentët duhet të:

- zotërojnë aftësi të plota analitike dhe sistematike të normave juridike si dhe aftësi për të trajtuar me shkrim dhe me gojë linjat e arsytimit dhe argumentimit ligjor, të cilat përfaqësojnë elementë të domosdoshëm për trajtimin e duhur të çështjeve juridike, aspektin material dhe procedural;
- ndërgjegjësohen për zhvillimin dhe rëndësinë e elementëve ndërkombëtarë në marrëdhëniet shoqërore e rrjedhimisht konflikteve të lidhura me to;
- jenë të aftë të përdorin rrjedhshëm me gojë dhe me shkrim, të paktën të një nga 5 gjuhët më të rëndësishme të BE, duke iu referuar veçanërisht fushës specifike disiplinore;
- përfitojnë njohuri të plota të disiplinave bazë të të tre shtyllave të së drejtës duke iu kushtuar një veçantë edhe mësimdhënies integruese apo karakterizuese apo dhe atyre me zgjedhje sipas profilit.

Programi ka një kohëzgjatje prej dy vitesh akademike, ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra.

Programi ka 120 ECTS, të cilat përfitohen nga përfundimi me sukses i 11 (njëmbëdhjetë) lëndëve të detyrueshme, 3 (tre) lëndëve me zgjedhje, praktikën profesionale dhe Temën e Diplomës. Kreditet janë përlllogaritur në përputhje me VKM Nr.41, dt. 24.01.2018 si dhe me Udhëzimin Nr.15, dt. 04.04.2008, shtojca 1, pika 4, për shpërndarjen e krediteve brenda 1 disipline mësimore, si dhe pika 5, për ndarjen e orëve mësimore për 1 kredit ECTS (meqenëse VKM Nr.41 nuk përcakton pikat 4 dhe 5, grupi i punës i është referuar Udhëzimit Nr.15, i cili ishte akti ligjor në fuqi përpara daljes së VKM Nr.41). Në përputhje me VKM Nr.41 pikën ç) dhe Shtojcën Nr.1 të tij, konkretisht, 1 krediti ECTS i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore. Literatura e detyrueshme si dhe literatura shtesë gjenden të detajuara në sylabuset e çdo lënde (**Evidencë 4.2**).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” është licensuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 408, dt. 26/05/2010. Programi është akredituar me kohëzgjatje 2 (dy) vjeçare me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 90, dt. 20/10/2017. Qëllimet dhe objektivat e programit janë përcaktuar qartë në Rregulloren e Programit dhe janë paraqitur në paragrafin e mësipërm (**Evidencë 1.1, Neni 4**).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” ofrohet si një program dy vjeçar. Çdo vit është i ndarë në dy semestra. Kalendarit akademik është i ndarë në muaj dhe javë. Në kalendar përcaktohen qartë edhe momentet e rëndësishme të programit, si për shembull fillimi i vitit akademik, periudhat e pushimit, sezonet e provimeve, afatet sa i përket procesit të shkrimit, mbikqyrjes, dorëzimit dhe vlerësimit të temës së diplomës, etj. Mbas analizës së dokumentacionit përkatës (**Evidencë 7.1**) dhe vizitës në IAL, rezulton se të dhënat e paraqitura në RVB janë të sakta dhe nuk ka ndryshime të konstatuara në to.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani sipas viteve akademike dhe ndarja sipas veprimtarive formuese paraqitet në tabelën 9 dhe 10 të Anekseve.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Programi ka 120 ECTS, të cilat përfitohen nga përfundimi me sukses i 11 (njëmbëdhjetë) lëndëve të detyrueshme, 3 (tre) lëndëve me zgjedhje, praktikën profesionale dhe Temën e Diplomës. Kreditet janë përlllogaritur në përputhje me VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 si dhe me Udhëzimin Nr. 15, dt. 04.04.2008, shtojca 1, pika 4, për shpërndarjen e krediteve brenda 1 disipline mësimore, si dhe pika 5, për ndarjen e orëve mësimore për 1 kredit ECTS (meqenëse VKM Nr. 41 nuk përcakton pikat 4 dhe 5, grupi i punës i është referuar Udhëzimit Nr. 15, i cili ishte akti ligjor në fuqi përpara daljes së VKM Nr. 41). Në përputhje me VKM Nr. 41 pikën ç) dhe Shtojcën Nr. 1 të tij, konkretisht, 1 krediti ECTS i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore. (**Evidencë 4.2**).

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Ndryshimet në planet mësimore paraqiten në tabelën 11 të Anekseve.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 12 e Anekseve)

Një nga problemet e hasura në lidhje me planet mësimore ka të bëjë me fushën e ekspertizës së pedagogëve që mbulojnë lëndë të caktuara. Kjo problematikë është trajtuar më në detaj më poshtë në analizën e syllabuseve.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Në përgjithësi mund të thuhet që syllabus-et i plotësojnë kriteret formale (**Evidencë 4.4.1., 4.4.2. dhe Dokumenti 3 dhe 7 të dërguar mbas vizitës në IAL**), pasi të gjithë syllabus-et përmbajnë elementët

e mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Siç u përmend më sipër, syllabus-et i plotësojnë kriteret formale. Megjithatë, disa çështje të konstatuara nga GVJ, të cilat u diskutuan edhe gjatë vizitës në IAL, vlejné për t'u përmendur në kuadër të analizës së syllabuseve.

Çështja e parë dhe më e rëndësishme në këtë analizë ka të bëjë me titullarin e lëndëve. Vetëm 4 (katër) nga lëndët e paraqitura në Planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës, rezultojné të kenë udhëheqës të lëndës pedagogë, të cilët aktualisht janë të angazhuar në mësimdhënie. Në lëndët e tjera, pra në shumicën e tyre, udhëheqësi i lëndës nuk figuron të jetë i përfshirë në mësimdhënie. Nga vizita në IAL rezulton se ky fenomen vjen si pasojë e kërkesave ligjore, sipas të cilave, udhëheqësi i lëndës duhet të ketë të paktën titullin Prof. As. Titullarët e lëndëve, të cilët nuk janë të përfshirë në mësimdhënie, nuk figurojnë as në komisionet e provimeve. Në vlerësimin e GVJ, titullari i lëndës duhet të përfshihet në mësimdhënie, qoftë dhe me një numër të kufizuar orësh. Përndryshe, paraqitja e një syllabusi me një titullar lënde të paangazhuar në mësimdhënie është fiktive. **(Evidencë 4.4.1., 4.4.2. dhe Dokumenti 2.2, 3, 6, 7, 30.1, 30.2, 30.3, 30.4 dhe 34 të dërguar mbas vizitës në IAL; Tabela 8 në Aneks)**

Një çështje tjetër e diskutuar gjatë vizitës në IAL, është mospërputhja e pedagogëve përgjegjës të disa syllabuseve me ata që figurojnë në Planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës. Në disa lëndë në syllabus figuron një tjetër pedagog përgjegjës nga ai/ajo që figuron në Planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës. IAL iu kërkua shpjegim për këto mospërputhje, por dokumentacioni i dërguar në lidhje me këtë çështje nuk jep një shpjegim të qartë. Gjithashtu, në vazhdim të këtyre mospërputhjeve, një nga pedagogët e brendshëm figuron në syllabuset disa lëndëve të cilat janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. **(Evidencë 4.4.1., 4.4.2. dhe Dokumenti 2.2, 3, 7, të dërguar mbas vizitës në IAL; Tabela 8 në Aneks)**

Syllabuset nuk janë gjithmonë të qartë sa i përket kompetencave që studentët marrin nga lënda e caktuar dhe objektivave mësimorë. Në disa raste, çfarë është paraqitur si kompetencë në fakt është objektiv mësimor ose anasjelltas. Për më tepër, prezantimi i kompetencave nuk është uniform. Në disa raste ato prezantohen si një rubrikë më vete në syllabus ndërsa në disa raste të tjera si pjesë narrative e përshkrimit të lëndës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programet e ofruara nga Departamenti i Shkencave Juridike janë të akredituara, të organizuara në module, të cilët vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Grumbullimit dhe të Transferimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek Programin e Studimit Master i Shkencave në Shkencë Juridike është 60 kredite (Evidencë 1.1, Kreu II, neni 8, fq. 8)</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master</p>	<p>Programi i Studimit Master i Shkencave në Shkencë Juridike synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe trajnim për kërkim shkencor (p.sh. në modulën Metodat e Kërkimit Shkencor). Për më tepër Programi në fjalë synon të zgjerojë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve (Evidencë 1.1, Kreu II, Neni 4, fq 2).</p> <p>Kompetencat e përgjithshme me të cilat Programi synon të pajisë studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit dhe në syllabuset e çdo lënde. Megjithatë, kompetencat e formuluar në Rregullore janë shumë të përgjithshme dhe të paqarta. Për më tepër, syllabuset nuk janë gjithmonë të qarta sa i përket kompetencave që studentët marrin nga lënda e caktuar dhe objektivave mësimorë. Në disa raste, çfarë është paraqitur si kompetencë në fakt është objektiv mësimor ose anasjelltas (Evidencë 1.1, Kreu II, Neni 4, fq 2; Evidencë 4.4.1., 4.4.2. dhe Dokumenti 2.2, 3, 7, të dërguar mbas vizitës në IAL). Mungesa e përcaktimit të kompetencave të qarta, që synohen të përcillen nëpërmjet programit në përgjithësi, e bën ende më të vështirë përcaktimin uniform të kompetencave për çdo modul si dhe përcaktimin e objektivave mësimorë. Normalisht, kompetencat duhen të përcaktohen në nivel programi dhe çdo modul përcakton se cilat nga kompetencat e programit synon të avancojë. Në varësi të kompetencave përcaktohen dhe objektivat mësimorë, nëpërmjet të cilëve arrihen kompetencat. Mbas</p>

<p>Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>vizitës në IAL, u dërgua një dokument nga Institucioni ku renditeshin disa kompetenca të studentit (Dokumenti 32 dërguar mbas vizitës në IAL). Këto kompetenca janë më të qarta sesa ato të renditura në rregulloren e Programit. Megjithatë, nuk është e qartë nëse këto kompetenca janë pjesë e një dokumenti formal të IAL.</p> <p>Nëpërmjet modulit Metodatat e Kërkimit Shkencor, i cili është i detyrueshëm për të gjithë studentët, pavarësisht profilit të zgjedhur prej tyre, Programi i Studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë të doktoratës.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Objektivat e Programit Master Shkencor në Shkenca Juridike janë përcaktuar në Rregulloren e Programit. Renditja dhe përbajtja e tyre janë në përputhje me qëllimin dhe nivelin e studimit të ciklit të dytë, të cilit i përket Programi (Evidencë 1.1, Kreu II, Neni 4, fq 2).</p> <p>Studentët vlerësohen nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive gjatë gjithë semestrit. Vlerësimi i tyre bëhet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimit përfundimtar 60 pikë (60%); - Provimit ndërmjetës 20 pikë (20%); - Pjesëmarrje aktive në seminar 10 pikë (10%); - Detyra individuale ose në grup 10 pikë (10%) <p>(Evidencë 1.1, Neni 24, fq 21-22; 4.4.1., 4.4.2. dhe Dokumenti 3, 7, të dërguar mbas vizitës në IAL).</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga vizita në IAL rezultoi se Departamenti i Shkencave Juridike të AU, nëpërmjet bashkëpunimit me disa Universitete të vendeve të BE-së, është mbështetur në praktikatat e mira të vendeve europiane. Ai është ndërkombëtarisht konkurrues për nga elementët që përmban. Programi është në përputhje me Procesin e Bolonjës.</p>

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Modulet e ofruara nga Programi Master Shkencor në Shkenca Juridike, mundësojnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Programi është hartuar në përputhje me Strategjinë për Zhvillim të IAL dhe Strategjinë e Departamentit të Shkencave Juridike (Evidencë 1.2 dhe 1.4).</p> <p>Angazhimi i personelit akademik në punën kërkimore konsiston kryesisht në referime në konferenca shkencore. Pjesa më e madhe e stafit akademik të angazhuar në Programin Shkencor në Shkenca Juridike nuk figuron të jetë angazhuar në punë kërkimore shkencore për realizimin e programit të studimit. Pjesëmarrja e tyre në konferenca është sporadike dhe jo detyruesisht e lidhur me programin studimor ku ata janë të angazhuar (Evidencë 4.5, 10.1, 10.2 dhe Dokumenti 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20.5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10 dhe 31 të dërguar mbas vizitës në IAL).</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	N/A
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Departamenti i Shkencave Juridike ka kryer një Analizë për Tregun e Punës për Programin Master i Shkencave në Shkenca Juridike, viti akademik 2018-2019 (Evidencë 7.7). Kjo analizë bazohet në të dhëna të përgjithshme të institucioneve të ndryshme dhe studime të kryera nga to. Analiza nuk është e fokusuar në nevojat e tregut për juristë në veçanti. Si rrjedhojë, nuk është e qartë nëse programi i studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike është i hartuar në përputhje me nevojat e tregut.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimit nuk bien ndesh me interesat kombëtarë dhe pasqyrojnë vullnetin e IAL për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Shkenca Juridike është në përputhje me nenin 75 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Nga vizita në IAL si dhe nga analiza e RVB dhe evidencave përkatëse, rezulton se informacioni i ofruar për programet e studimeve është lehtësisht i konsultueshem për studentët dhe ofrohet në forma të ndryshme të shkruara, nëpërmjet broshurave dhe elektronikisht (Evidencë 7.8, 7.9 si dhe https://albanianuniversity.edu.al/sq/broshura-per-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve/dhe https://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-i-studenteve/).</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Manuali për punimin e temë së diplomës shpjegon në mënyrë të detajuar metodologjinë që duhet ndjekur për punimin e temës së diplomës (Evidencë 3.9). Tema të tilla, se si duhet strukturuar një temë diplome, metodat e kërkimit dhe citimit, pra mënyra e shkrimit të temës gjejnë pasqyrim në këtë manual. Megjithatë, ky manual nuk mund të thuhet që</p>

shpjegon mënyrën e diplomimit, në sensin e procedurës që duhet ndjekur dhe afatet e parashikuara për diplomim.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.
2. Kompetencat e formuluar në Rregullore janë shumë të përgjithshme dhe të paqarta. Për më tepër, syllabuset nuk janë gjithmonë të qartë sa i përket kompetencave që studentët marrin nga lënda e caktuar dhe objektivave mësimorë.
3. Programi i Studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë të doktoratës. Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohet.
4. Studentët vlerësohen nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive gjatë gjithë semestrit.
5. Programi është në përputhje me Procesin e Bolonjës.
6. Modulet e ofruara nga Programi Master Shkencor në Shkenca Juridike, mundësojnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.
7. Pjesa më e madhe e stafit akademik të angazhuar në Programin Shkencor në Shkenca Juridike nuk figuron të jenë angazhuar në punë kërkimore shkencore për realizimin e programit të studimit.
8. Programi është hartuar në përputhje me Strategjinë për Zhvillim të IAL dhe Strategjinë e Departamentit të Shkencave Juridike.
9. Nuk është e qartë nëse programi i studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike është i hartuar në përputhje me nevojat e tregut.
10. Programet e studimit nuk bien ndesh me interesat kombëtarë dhe pasqyrojnë vullnetin e IAL për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Ato janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sa i përket krediteve dhe kohëzgjatjes.
11. Informacioni i ofruar për programet e studimeve është lehtësisht i konsultueshëm për studentët dhe ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike. Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia organizohet në bazë kursi, grupi dhe nëngrupi. Format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, detyrat e krusit, projektet dhe ushtrimet. Frekuentimi i të gjitha formave të mësimdhënies është i detyrueshëm. Studentët që kanë kryer më shumë se 25% mungesa, por më pak se 50%, ai/ajo

nuk pranohen në sesionin e parë të provimeve, por ka të drejtë të pranohet në sesionin e dytë të provimeve. Studentët që kanë kryer më shumë se 50% mungesa, shpallet përsëritës në lëndën përkatëse (**Evidencë 1.2**). Nga vizita në IAL rezulton se ky rregull zbatohet në praktikë.

Kontrolli i njohurive të studentëve dhe format e kontrollit janë përcaktuar qartë në Rregulloren e Programit dhe në syllabusin e çdo lënde (**Evidencë 1.2 shih dhe Tabela 10 në Aneks**). Metodatat e mësimdhënies janë një ndërthurje midis metodës *ex cathedra* dhe asaj interaktive.

Mësimdhënia vlerësohet nga studentët nëpërmjet formularëve të vlerësimit dhe nga NjSBC përmes *focus* grupeve. Për më tepër, studentët mund të shprehin mendimet e tyre rreth procesit të mësimdhënies përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor, kryetari i të cilit është anëtar i Senatit Akademik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 13 e Anekseve):

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Detyra

Format e mësimdhënies janë klasike. Pra leksione, seminare, detyra dhe ushtrime. Nga vizita në IAL rezultoi se bëhet kujdes që mësimdhënia të jetë sa më interaktive. Një problem i konstatuar ka të bëjë me praktikën profesionale.

Format e kontrollit të njohurive (Tabela 14 e Anekseve)

Nga vizita në IAL rezulton se kontrolli i njohurive bëhet nëpërmjet, detyrave, pjesëmarrjes aktive apo pasive në mësim dhe provimeve/testeve. Detyrat mund të paraqiten në formën e nje prezantimi, në grup ose individual, ose të një eseje.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, etj. (Tabela 15 e Anekseve)

Nga intervistat e kryera me studentët rezulton që aktivizimi i tyre mbetet marginal. Në rastin më të mirë ata aktivizohen në organizimin e eventeve. Por edhe ky aktivizim rezulton të jetë i vakët dhe jo gjithëpërfshirës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

9. STUDENTËT

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Rregullorja e Studimeve Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”, miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr.56 datë 07.11.2018, nënenin 10 të saj ka parashikuar kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve në programin e studimit “Master i Shkencave në Shkenca Juridike” (Evidencë 1.1).

Në profilin “E drejtë publike administrative”, për vitin 2017-2018, janë regjistruar gjithsej 22

studentë, të cilët janë të transferuar nga filiali i Beratit dhe të gjithë studentët janë të matrikulluar. Për vitin 2018-2019, në këtë profil, vetëm 7 studentë janë regjistruar për herë të parë.

Në profilin “E drejtë penale”, për vitin 2017-2018, rezultojnë të regjistruar gjithsej 19 studentë, prej të cilëve 11 janë të transferuar dhe 8 të regjistruar për herë të parë. Për vitin 2018-2019, nga 44 studentë të regjistruar në këtë profil, 20 janë të transferuar nga SHLUJ “Justicia” dhe 24 janë të regjistruar për herë të parë.

Në profilin “E drejtë Private”, për vitin 2017-2018, nga 24 studentë të regjistruar gjithsej, 7 janë të transferuar, ndërsa 17 janë të regjistruar për herë të parë. Për vitin 2018-2019, nga 24 studentë të regjistruar gjithsej, 15 janë të transferuar nga SHLUJ “Justicia”, ndërsa 9 janë të regjistruar për herë të parë.

Kohëzgjatja normale e studimeve në këtë program studimi është 2 vite akademike dhe afati maksimal i kohëzgjatjes së studimeve është 4 vite akademike (dyfishi i kohës së rregullt), pa përfshirë kohën e pezullimit të studimeve. Studenti lejohet të regjistrohet në vitin pasardhës nëse ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit paraardhës. Lëndët të cilave u përkasin kreditet e mbetura konsiderohen detyrime të mbartura (Rregullorja e Studimeve “Master i Shkencave në Shkenca Juridike”, neni 25, Evidencë 1.1.).

Informimi i studentëve në lidhje me programin e studimit bëhet që në kontaktin e parë të tyre me stafin akademik dhe administrativ të AU. Studentët informohen në lidhje me programin e studimit, në lidhje me planin kalendarik të ngarkesës mësimore, plan-programet e lëndëve, listën e literaturës. Institucioni zhvillon javën e orientimit të studentëve në fillim të çdo viti akademik, ku studentët njihen me ambientet e shkollës si dhe informohen mbi veprimtaritë mësimore-shkencore. Për këtë arsye është publikuar dhe një fletë-palosje informative, e titulluar “Përmbledhje Normative” (e marrë në hard copy, nga vizita në institucion), ku studenti informohet në lidhje me: statusin e studentit; të drejtat dhe detyrimet e tij, aktivitetet studentore, kontrollin e njohurive, vlerësimi në provime dhe shlyerja e tyre, sezonet e provimeve, korigjimi i tyre, rregullat e etikës dhe shkeljet etike, etj. (sipas informacionit të evidentuar në minutat e takimit gjatë vizitës në Institucion).

Institucioni ka ngritur Zyrën e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve (tutorials dhe mentorimi), si një njësi e ngritur pranë rektoratit, në funksion të procesit mësimor dhe shkencor, të parashikuar në nenin 11 të Statutit të AU. Kjo zyrë organizon javën orientuese në fillim të vitit akademik. Gjithashtu, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes realizon gjatë vitit aktivitete të tjera këshilluese, orientuese dhe ekstrakurrikulare (aktivitete sportive, etj). Nga zyra organizohet “Open day” për maturantët në 31 Maj – 1 Qershor. Kjo zyrë luan një rol ndërmjetës midis departamentit e zyrave të AU në njërin anë dhe studentëve në anën tjetër (dokument shtesë nr.39, pas vizitës në IAL).

Institucioni ka ngritur dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumnit të parashikuar në nenin 11 të Statutit të AU. Funksionimi i kësaj zyre bëhet në përputhje me Rregulloren e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit (dokument shtesë nr.40, i paraqitur pas vizitës në Institucion). Kjo zyrë tenton të krijojë lidhje midis studentëve dhe tregut të punës. Aktiviteti kryesor i realizuar nga kjo zyrë është panairi i punës (psh. panairi i punësimit i vitit 2016 <https://www.youtube.com/watch?v=ztrjISM4yws>). Zyra administron një database, me të dhënat e studentëve të diplomuar, që konsistojnë në pjesën e Alumnit, nëse janë punësuar dhe ku janë punësuar. Nga të dy zyrat (“Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve” dhe “Zyra e Karrierës dhe Alumnit”) është hartuar Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës, qëllimi i të cilit është dhënia e informacioneve ndaj studentëve të AU për të zgjedhur sa më lehtë karrierën e tyre (dokument nr.41, pas vizitës në IAL).

Në gjykimin tonë numri i stafit administrativ të angazhuar në këto zyra është i pamjaftueshëm. Në secilën prej tyre ishte punësuar vetëm një specialist.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Rregullorja e Studimeve “Master i Shkencave në Shkenca Juridike”, në nenin 10 të saj ka parashikuar si kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit “Master i Shkencave në Shkenca Juridike”:

- Të ketë një diplomë të nivelit bachelor, me kohëzgjatje minimale 3 vjet;
- Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimit të njësisë bazë;
- Të paguajë tarifën vjetore;
- Të njohë një nga 5 gjuhët e BE-së, sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentat që kandidati paraqet në dosje miratohen paraprakisht nga komisioni i pranimit, që ngrihet nga njësisia bazë. Konkretisht Departamenti i Shkencave Juridike, me Vendimin e datës 30.08.2018 ka miratuar komisionin e “Njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve”, i cili është ngarkuar me detyrën e vlerësimit të kandidatëve fitues për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve (Shkresa Nr.382 Prot., datë 30.08.2018, evidencë shtesë pas vizitës nëIAL, dokument nr.75). Po kështu, më datë 20.10.2018, Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Juridike i ka përcjellë Dekanit të Fakultetit, listat e kandidatëve fitues në programin e ciklit të dytë “Shkenca Juridike”, në të 3 profilet (shkresa Nr.97/4 Prot., datë 20.10.2018, evidencë shtesë pas vizitës nëIAL, dokument nr.57).

Pavarësisht së Komisioni i Pranimit është ngritur nga Departamenti, sikurse e parashikon rregullorja, nuk evidentohet ndonjë shkresë apo procesverbal i këtij komisioni që të vërtetojë se ka qenë ky komision ai që ka miratuar kriteret akademike (psh që ka miratuar **notën mesatare**) të pranimit të studentëve apo ndonjë dokument që provon se dokumentat e paraqitura nga studentët janë verifikuar dhe vlerësuar nga ky komision. Sipas të dhënave të marra nga biseda me sekretarinë e Fakultetit (nga minutat gjatë vizitës në institucion), pyetjes: “*Notën mesatare të studentëve në hyrje, kush e verifikon?*”, ju përgjigjën: “*Nota mesatare verifikohet nga sekretaria mësimore, nga lista e notave që sjellin studentet*”. Pra ngritja e komisionit të pranimit ka qenë thjesht një procedurë formale e Departamentit për të respektuar formalisht një kërkesë të Rregullores. Sikurse konstatohet dhe nga tabelat në anekse, nota mesatare e pranimit të këtyre studentëve ka qenë e ndryshme në vite dhe profile të ndryshme dhe nuk ka dokumenta që provojnë se kjo notë mesatare është miratuar për çdo vit akademik dhe për çdo profil nga komisioni i pranimit.

Nga verifikimi i dosjeve të studentëve në Sekretarinë mësimore, u konstatuan këto dokumenta:

- a. Dosje Studenti, i regjistruar për herë të parë: -Mandat arkëtimi, dy foto, ID, Kontratë Studimi, Deklarata e përdorimit të të dhënave dhe e regjistrimit, Formular aplikimi, Vërtetim i listës së notave, Diploma Bsc, Dëftesa e shkollës së mesme, Dëshmi e gjuhës së huaj.
- b. Dosje studenti të transferuar: -Mandat pagesash, Vendim i komisionit të njohjes së krediteve, Kontratë studentit, Listë notash, Dëftesa e shkollës së mesme, Formular aplikimi, ID, Dëshmi për përdorimin e të dhënave, Vërtetim ç’regjistrimi nga SHLUJ “Justicia”, Diploma Bsc, Listë notash nga SHLUJ “Justicia”, Syllabuset e lëndëve që ka kryer tek SHLUJ “Justicia”.

Numri i rekrutimeve të studentëve paraqitet në tabelën 16 të Anekseve.

a. Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” me profil “ E drejtë publike dhe Administrative”

Në vitin akademik 2017-2018 nuk ka studentë të regjistruar në vit të parë për herë të parë por vetëm 22 studentë të regjistruar me transferim në vit të dytë. Në vitin akademik 2018-2019 janë të regjistruar 7 studentë në vit të parë për herë të parë.

b. Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” me profil “ E drejtë penale”

Në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar në total 19 studentë prej të cilëve 8 studentë janë regjistruar në vit të parë për herë të parë dhe 11 studentë janë regjistruar me transferim në vit të dytë. Në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar në total 44 studentë prej të cilëve 24 studentë janë regjistruar për herë të parë në vit të parë dhe 20 studentë të regjistruar me transferim në vit të dytë.

c. Master i Shkencave në "Shkenca Juridike" me profil "E drejtë private".

Në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 17 studentë për herë të parë në vit të parë dhe 7 studentë regjistruar me transferim në vit të dytë. Në total në këtë vit akademik janë regjistruar 24 studentë. Në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 9 studentë për herë të parë në vit të parë dhe 15 studentë të regjistruar me transferim në vit të dytë.

Numri i studentë të diplomuar paraqitet në tabelën 17 të Anekseve.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve:

Nota mesatare varion nga 6.06 në 8.3.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë):

- Në profilin "E drejtë publike administrative", për vitin 2017-2018, janë regjistruar gjithsej 22 studentë, të cilët janë të transferuar nga filiali i Beratit dhe të gjithë studentët janë të matrikulluar. Për vitin 2018-2019, në këtë profil, vetëm 7 studentë janë regjistruar për herë të parë.
- Në profilin "E drejtë penale", për vitin 2017-2018, rezultojnë të regjistruar gjithsej 19 studentë, prej të cilëve 11 janë të transferuar dhe 8 të regjistruar për herë të parë. Për vitin 2018-2019, nga 44 studentë të regjistruar në këtë profil, 20 janë të transferuar nga SHLUJ "Justicia" dhe 24 janë të regjistruar për herë të parë.
- Në profilin "E drejtë Private", për vitin 2017-2018, nga 24 studentë të regjistruar gjithsej, 7 janë të transferuar, ndërsa 17 janë të regjistruar për herë të parë. Për vitin 2018-2019, nga 24 studentë të regjistruar gjithsej, 15 janë të transferuar nga SHLUJ "Justicia", ndërsa 9 janë të regjistruar për herë të parë.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend:

Gjatë vitit akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 në IAL ka studentë të transferuar nga IAL të tjera brenda vendit, sipas tabelave përkatëse për çdo profil. Nga Departamenti ngrihet Komisioni i "Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të studimeve", që është formalisht i njëjti komisioni që bën dhe vlerësimin dhe pranimin e kandidatëve fitues për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve. Ky komision ka marrë vendim për çdo student të transferuar.

Të dhëna për punësimin e studentëve:

Nga numri total i të diplomuarve (72 studentë), 60 janë të punësuar.

Numri total të diplomuarve:

Numri total i të diplomuarve në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca juridike", gjatë 2 viteve akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 është 72 studentë.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën):

Nga numri total i studentëve të punësuar (60 studentë), 45 janë të punësuar në përputhje me diplomën.

- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën):

Nga numri total i studentëve të punësuar (60 studentë), 15 janë të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Studentët që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike, zotërojnë një diplomë universitare të nivelit “Bachelor” me 180 ECTS, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore.</p> <p>Dëshmia e gjuhës së huaj është miratuar si një kriter pranimi për studentët e programit të studimit Master i Shkencave dhe administrohet si dokument në dosjen e studentit.</p> <p>IAL ka parashikuar kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit “Master i Shkencave në Shkenca Juridike” si dhe ka ngritur komisionin për vlerësimin e këtyre kriterëve. Por ngritja e komisionit të pranimit ka qënë thjesht një procedurë formale e Departamentit për të respektuar formalisht një kërkesë të Rregullores. Pranimi i studentëve dhe verifikimi i dokumentacionit të tyre bëhet nga Sekretaria Mësimore. Nota mesatare e pranimit të këtyre studentëve ka qënë e ndryshme në vite dhe profile të ndryshme dhe nuk ka dokumenta që provojnë se kjo notë mesatare është miratuar për çdo vit akademik dhe për çdo profil nga komisioni i pranimit.</p> <p>Studentët paraqesin për pranimin në programin e studimit Master i Shkencave, dosjen përkatëse, e cila administrohet nga Sekretaria Mësimore.</p> <p>Nuk dokumentohet nga IAL vlerësimi politikave të pranimit të studentëve dhe miratimi i ndryshimeve të kriterëve të pranimit të tyre gjatë dy viteve akademike (2017-2018 dhe 2018-2019).</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentëve u jepet informacion për mundësitë e punësimit pas diplomimit të tyre.</p> <p>Informimi i studentëve në lidhje me programin e studimit bëhet që në javën e parë të vitit akademik, në “javën orientuese”. Studentët informohen në lidhje me programin e studimit, akreditimin dhe vlefshmërinë e tij.</p> <p>Njohja e studentëve me të drejtat dhe detyrimet e veta, aktivitetet studentore, kontrollin e njohurive, vlerësimin në provime, rregullat e etikes, etj., bëhet nëpërmjet broshurës “Përmbledhje Normative” (dokument i parë/marrë gjatë vizitës në IAL).</p> <p>Studentët mbështeten dhe informohen për zhvillimin e karrierës. Për këtë qëllim është hartuar Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës, qëllimi i të cilit është dhënia e informacioneve ndaj studentëve të AU për të zgjedhur sa më lehtë karrierën e tyre (evidencë).</p> <p>Grupi i ekspertëve të jashtëm rekomandon shtimin e numrit të punonjësve në “Zyrën e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve”, si dhe në “Zyrën e Karrierës dhe Alumnit”, në kushtet kur një punonjës i vetëm, për çdo zyrë, ka përgjegjësinë për mbështetjen e gjithë studentëve të IAL-së.</p>
---	---

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet “Zyrës së Karrierës dhe Alumnit” disponon të dhëna të sakta mbi numrin e studentëve të diplomuar.</p> <p>IAL disponon statistika të sakta në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”.</p> <p>Gjithashtu disponohen të dhëna të sakta për numrin e studentëve të transferuar në këto programe, të larguar nga ky program (ç’regjistruar).</p>
---	---

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet “Zyrës së Karrierës dhe Alumnit” dhe kontaktit me studentët, disponon të dhëna të sakta për punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve në këtë program Master i Shkencave në Shkenca Juridike. Gjithashtu mbahen të dhëna për studentët që vazhdojnë ciklet e tjera të studimeve.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit tenton të krijojë lidhje midis studentëve dhe tregut të punës, nëpërmjet organizimit të panairit të punës.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Takime informuese me studentët për programin e studimit, planin e realizimit të këtij programi, afatin e përfundimit të tij, etj. realizohen gjatë vitit akademik me përfaqësues të Departamentit. Informimi i studentëve në lidhje me programin e studimit bëhet që në javën e parë të vitit akademik, në “javën orientuese”, të organizuar nga Departamenti dhe “Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve”.</p> <p>Studentët marrin informacion edhe nga pedagogu i lëndës dhe nga sekretaria mësimore, në lidhje me vlerësimin përgjatë semestrit.</p> <p>Studentët marrin informacion edhe për vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar të tyre, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Programit të Studimeve Master i Shkencave në Shkenca Juridike (neni 23/3).</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike ofron këshillim për studentët dhe kujdestari (tutorial) gjatë gjithë periudhës 2 vjeçare të studimeve.</p> <p>Institucioni, nëpërmjet Departamentit dhe “Zyrës së Karrierës dhe Alumnit”, orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit ku ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<p>1. Rekrutimi i studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike (me drejtime), bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve normative nënligjore. IAL ka parashikuar kritere të pranimit të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” si dhe ka ngritur komisionin për vlerësimin e këtyre kritereve. Por ngritja e komisionit të pranimit ka qënë thjesht një procedurë formale e Departamentit për të respektuar formalisht një kërkesë të Rregullores. Pranimi i studentëve dhe verifikimi i dokumentacionit të tyre bëhet nga Sekretaria Mësimore. Nota mesatare e pranimit të këtyre studentëve ka qënë e ndryshme në vite dhe profile të ndryshme dhe nuk ka dokumenta që</p>	

provojnë se kjo notë mesatare është miratuar për çdo vit akademik dhe për çdo profil nga komisioni i pranimit.

2. Institucioni, nëpërmjet Departamentit dhe Sekretarisë Mësimore mban të informuar studentët në lidhje me programin e studimit dhe elementët e tij, si dhe mbi ecurinë e përbushjes së detyrimeve kurrikulare.
3. IAL, nëpërmjet “Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve” dhe “Zyrës së Karrierës dhe Alumnit” mban të informuar studentët në lidhje me akreditimin dhe vlefshmërinë e programit të studimit, statusin dhe të drejtat e detyrimit e studentëve. Rekomandohet shtimi i numrit të punonjësve në “Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve”, si dhe në “Zyrën e Karrierës dhe Alumnit”.
4. Institucioni mban të dhëna për punësimin e studentëve, si dhe ndërmerr masa për të ndërmjetësuar punësimin e tyre.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Politikat në lidhje me kërkimin shkencor janë përcaktuar në Strategjinë e Departamentit të Shkencave Juridike. Nga vizita në IAL dhe dokumentacioni i dërguar nga IAL mbas vizitës, rezulton se numri i botimeve nga stafi akademik në vite është i ulët. IAL nuk ka një politikë të caktuar sa i përket cilësisë dhe sasisë së botimeve. Botimet e Departamentit të Shkencave Juridike në revistën periodike “OPTIME”, botim i AU, janë të pakta dhe jo nga stafi akademik i angazhuar në Programin Master Shkencor në Shkenca Juridike. Kryesisht kërkimi shkencor konsiston në pjesëmarrje dhe/ose referime në konferenca të organizuara nga Departamenti i Shkencave Juridike ose në studime për përfundimin e doktoraturës. Si Strategjia e Departamentit të Shkencave Juridike ashtu edhe Strategjia për Zhvillim e IAL, kanë si objektiv ndërthurjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien. Megjithatë, nga vizita në IAL dhe analiza e dokumentacionit përkatës, rezulton se ekzistojnë edhe ndërkohë nuk realizohet ashtu siç synohet, pasi vetëm një numër shumë i vogël i stafit akademik janë përfshirë në punë shkencore që lidhet me lëndën që ata japin në programin në fjalë (**Evidencë 1.2, 4.5, 10.1, 10.2 dhe Dokumenti 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20.5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10 dhe 31 të dërguar mbas vizitës në IAL**).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 18 e Anekseve)

Kërkimi shkencor konsiston kryesisht në pjesëmarrje në konferenca të ndryshme të organizuara nga IAL ose nga institucione të tjera, vendase apo të huaja. Në disa raste rezultojnë të ketë dhe publikime, por ato janë në shumicën e rasteve publikime të procedimeve të konferencave shkencore. Në raste të veçanta dhe të izoluara, ka publikime në revista apo dhe monografi. Vetëm IAL publikon një revistë shkencore, megjithatë publikimet në fushën juridike në këtë revistë janë minimale dhe jo nga stafi akademik i angazhuar në Programin Master Shkencor në Shkenca Juridike.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Publikimet e personelit akademik të angazhuar në Programin Master Shkencor në Shkenca Juridike janë sporadike. Ato konsistojnë kryesisht në referime në konferenca të organizuara nga Departamenti dhe si rrjedhojë kontributi në zhvillimin e shkencës është modest. Botimet e Departamentit të Shkencave Juridike në revistën periodike "OPTIME", botim i AU, janë të pakta dhe jo nga stafi akademik i angazhuar në Programin Master Shkencor në Shkenca Juridike. Nga formularët e deklaramit të aktivitetit kërkimor shkencor të pedagogëve, të vëna në dispozicion nga IAL, rezultojnë, (përveç një rasti) që të gjithë pedagogët aktivitetin e tyre kërkimor e kanë të përqëndruar në pjesëmarrje në konferenca. Disa nga pedagogët kanë qenë dhe referues në këto konferenca. Në një rast është deklaruar vetëm publikimi i dy artikujve dhe një monografie, por pa të dhëna sa i përket titujve të publikimeve, vitit të publikimit të tyre, ku janë publikuar etj. Në pothuajse të gjitha deklaramet, vihet re që pedagogët deklarojnë si punë kërkimore shkencore pjesëmarrjen në trajnime (si trajnues apo si të trajnuar). Nuk është e qartë se ku konsiston puna kërkimore shkencore në pjesëmarrje në trajnime. Për më tepër, vihet re një mospërputhje (në shumicën e rasteve) të punës kërkimore me disiplinën/lëndën që pedagogët mbulojnë në Programin Master Shkencor në Shkenca Juridike (Evidencë 1.2, 4.5, 10.1, 10.2 dhe Dokumenti 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20.5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10 dhe 31 të dërguar mbas vizitës në IAL).</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë</p>	N/A

në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtëjshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtëjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni ofron programin e ciklit të tretë Doktoratë në “E Drejtë Europiane dhe e Kontratave”. Nga vizita në IAL rezultoi se NjsBC realizon trajnime me personelin akademik mbi tema që lidhen me mësimdhënien. Gjithashtu, në bashkëpunim me Universitetin e Salernos, është organizuar një trajnim i stafit akademik mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Megjithatë, nuk rezulton të jenë ofruar kualifikime apo trajnime në lidhje me kërkimin shkencor.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore, botimeve, projekteve kërkimore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi (Evidencë 10.1 dhe Dokumenti 20.1, 20.2, 20.3, 20.4, 20.5, 20.6, 20.7, 20.8, 20.9, 20.10 dhe 31 të dërguar mbas vizitës në IAL).</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Personeli akademik është i angazhuar sporadikisht në kërkim shkencor. 2. Publikimet dhe studimet shkencore janë të pakta dhe institucioni nuk ka një politikë efektive për nxitjen e kërkimit shkencor. 	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Marrëveshjet janë të një karakteri të përgjithshëm. Në to parashikohet bashkëpunimi në fusha të ndryshme, si për shembull nxitja e kërkimit shkencor, mobiliteti i stafit dhe studentëve, shkëmbim

informacioni, vënia në dispozicion e ambienteve etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela 19 e Anekseve)

Departamenti i Shkencave Juridike ka nënshkruar 15 marrëveshje, të cilat janë ende aktive për vitin akademik 2018-2019 (**Evidencë 11.1 dhe Dokumenti 9.1-9.15 të dërguar mbas vizitës në IAL**). Marrëveshjet janë të lidhura me gjykata, prokurori, zyra avokatie apo noterie, OJF, Ministrinë e Drejtësisë dhe Universitete të huaja. Marrëveshjet e lidhura janë në rrang institucional. Përmbajtja e tyre ndryshon nga një institucion në tjetrin, por ajo që bien në sy është se këto marrëveshje nuk janë lidhur specifikisht për Programin Master Shkencor në Shkenca Juridike. Gjithatë, siç u theksua më sipër, këto marrëveshje kanë një karakter të përgjithshëm dhe për këtë arsye ofrojnë fleksibilitet për të akomoduar nevojat e Programit.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 20 e Anekseve)

Nga vizita në IAL rezultoi që komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë, konsiston kryesisht në marrëveshjet e lidhura dhe të përshkruara më sipër. Përveç këtyre marrëveshjeve, IAL organizon vetë ose merr pjesë dhe lehtëson pjesëmarrjen e studentëve në panairt e ndryshme të punësimit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese; Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private (Evidencë 11.1 dhe Dokumenti 9.1-9.15 të dërguar mbas vizitës në IAL). Praktika profesionale është futur rishtazi si lëndë në Programin Master Shkencor në Shkenca Juridike. Prandaj, siç u pohua edhe gjatë vizitës në IAL, këto marrëveshje do të jenë të vlefshme për realizimin e praktikës profesionale në vitin akademik 2019-2020. Mbetet për t’u vlerësuar në një moment tjetër nëse marrëveshjet e bashkëpunimit do të jenë funksionale për këtë qëllim.
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Nga vizita në IAL rezultoi se institucioni nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. GVJ konstatoi se niveli i bashkëpunimit të brendshëm dhe shkëmbimit të informacionit është i kënaqshëm.</p>
--	--

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga vizita në IAL rezultoi se janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa Universitete Italiane. Bashkëpunimi rezulton në organizimin e disa konferencave ndërkombëtare, ne vizita studimore dhe në ofrimin e trajnimit të stafit akademik ne metodat e mësimdhënies.</p> <p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private (Evidencë 11.1 dhe Dokumenti 9.1-9.15 të dërguar mbas vizitës në IAL). Praktika profesionale është futur rishtazi si lëndë në Programin Master Shkencor në Shkenca Juridike. Prandaj, siç u pohua edhe gjatë vizitës në IAL, këto marrëveshje do të jenë të vlefshme për realizimin e praktikës profesionale në vitin akademik 2019-2020. Mbetet për t'u vlerësuar në një moment tjetër nëse marrëveshjet e bashkëpunimit do të jenë funksionale për këtë qëllim.</p> <p>Nuk rezulton të jenë organizuar trajnime profesionale të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësit dhe as të jetë kryer një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. GVJ konstaton se Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private. Megjithatë, mbetet për t'u vlerësuar në një moment tjetër nëse marrëveshjet do të jenë të dobishme për kryerjen e praktikës profesionale, mbasi kjo do të jetë e mundur duke filluar nga viti akademik 2019-2020.
2. Niveli i bashkëpunimit të brendshëm dhe shkëmbimit të informacionit është i kënaqshëm.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E KONSTATIMEVE TË DHËNA NGA AKREDITIMI I PARË

I. 1. Konstatimet e Bordit të Akreditimit:

Në vendimin e akreditimit të parë Nr. 49/2017 nuk janë lënë rekomandime. Në faqen 2 të Vendimit Nr. 49/2017 janë evidentuar disa pika të dobëta të konstatuara nga procesi i vlerësimit të jashtëm dhe konkretisht:

- a. Staf i akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi nuk mbulon 70% të ngarkesës mësimore;
- b. Praktika nuk është përfshirë si lëndë/modul i veçantë në kurrikulën e programit të studimit;
- c. Studentët nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në botime shkencore;
- d. Vlerësimi i procesit të mësimdhënies dhe nxënies realizohet vetëm në rang institucional;
- e. Nuk është realizuar një studim tregu lidhur me nevojat e tregut për këtë program studimi.

I. 2. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

Vlerësimi nga ekspertët e jashtëm për masat e marra nga IAL e vlerësuar, për këto pika të dobëta, të konstatuara nga akreditimi i parë, paraqitet si më poshtë:

- a. Për vitin akademik 2017-2018 vazhdon të evidentohet e njëjta dobësi dhe kriteri nuk ishte përmbushur, pasi raporti midis orëve mësimore të mbuluar nga stafi i brendshëm dhe atyre të mbuluara nga stafi i jashtëm është **33.9%** me **66.1%**. Për vitin akademik 2018-2019 ky raport është përmirësuar, pasi personeli akademik me kohë të plotë mbulon pothuajse **70% (69.5%)** të ngarkesës mësimore. Pra për vitin 2018-2019 janë marrë masa dhe ky kriter është përmbushur kryesisht. **Ky konstatim është përmbushur kryesisht.**
- b. Për vitin akademik 2018-2019, praktika është përfshirë si lëndë/modul i veçantë në kurrikulën e programit të studimit. **Ky konstatim është përmbushur.**
- c. Studentët përsëri nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në botime shkencore. **Ky konstatim është përmbushur pjesërisht.**
- d. Vlerësimi i procesit të mësimdhënies dhe nxënies realizohet edhe në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. **Ky konstatim është përmbushur.**
- e. Është hartuar si dokument një “Analizë për Tregun e Punës”, për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca juridike”, me drejtime, për vitin akademik 2018-2019, por më shumë ai i referohet objektivave të programit të studimit dhe disa të dhënave të INSTAT-it për numrin e papunësisë. Nuk ka një analizë apo studim të vërtetë mbi numrin e studentëve të punësuar si jurist, që do të justifikonte nevojën e hapjes së këtij programi studimi. **Ky konstatim është përmbushur pjesërisht.**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES - MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. AU angazhohet seriozisht në përmirësimin e programit studimor. Kështu AU, në Planin Strategjik të Zhvillimit Insitucional 2017-2022, ka parashikuar si një nga objektivat e tij pikërisht përmirësimin e programeve studimore. Gjithashtu fakt është që struktura përkatëse angazhohet çdo vit në rishikimin e programeve mësimore në funksion të përmirësimit të tyre.
2. Programi i Studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë të doktoratës.
3. Bashkëpunimi i brendshëm ndërmjet strukturave drejtuese të AU dhe shkëmbimi i informacionit midis tyre paraqitet në nivel të lartë.
4. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private.
5. Biblioteka online "QUESTIA" ofron për studentët dhe stafin akademik literaturë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, duke krijuar mundësi për realizimin me sukses të programit të studimit, si dhe të kërkimit shkencor.
6. Institucioni, nëpërmjet Departamentit, Sekretarisë Mësimore, "Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve" dhe "Zyrës së Karrierës dhe Alumnit" mban të informuar studentët në lidhje me programin e studimit dhe elementët e tij, ecurinë e përmbushjes së detyrimeve kurrikulare, akreditimin dhe vlefshmërinë e programit të studimit, statusin dhe të drejtat e detyrimit e studentëve. Informacioni i ofruar për programin e studimit është lehtësisht i konsultueshëm për studentët dhe ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.
7. Institucioni mban të dhëna për punësimin e studentëve, si dhe ndërmerr masa për të ndërmjetësuar punësimin e tyre.

b. Pika të dobëta:

1. Plani Strategjik i Zhvillimit Insitucional 2017-2022 nuk është i shoqëruar me një plan veprimi me masa konkrete dhe të matshme.
2. Mungon analiza krahasimore dhe reflektimi ndaj mangësive të konstatuara në raportin semestral ose në raportin vjetor të vetëvlerësimit.
3. Emërtimi i programit të studimit është Master i Shkencave në "Shkenca juridike" dhe është në përputhje me nivelet e përcaktuara nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Shtesa e emërtimit me profile në "E drejtë publike dhe administrative", "E drejtë private" dhe "E drejtë penale" nuk është plotësisht e justifikuar, duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e formimit profilizues që merr studenti.
4. Kompetencat e formuluar në Rregullore janë shumë të përgjithshme dhe të paqarta. Për më tepër, syllabuset nuk janë gjithmonë të qartë sa i përket kompetencave që studentët marrin nga lënda e caktuar dhe objektiveve mësimorë.
5. Nuk është e qartë nëse programi i studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike është i hartuar në përputhje me nevojat e tregut.



6. Vetëm 4 (katër) nga lëndët e paraqitura në Planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës, rezultojnë të kenë udhëheqës të lëndës pedagogë, të cilët aktualisht janë të angazhuar në mësimdhënie.
7. Në vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar në mësimdhënie 2 pedagoge me diplomë Msc (1 PAE dhe 1 PAK). Në vitin akademik 2018-2019 ka vetëm 1 pedagog me diplomë Msc (PAK) i angazhuar në këtë program studimi.
8. Pjesa më e madhe e stafit akademik të angazhuar në programin Master Shkencor në Shkenca Juridike nuk figuron të jenë angazhuar në punë kërkimore shkencore për realizimin e programit të studimit. Publikimet dhe studimet shkencore janë të pakta dhe institucioni nuk ka një politikë efektive për nxitjen e kërkimit shkencor.
9. IAL nuk ndjek procedura publike transparente konkurimi për rekrutimin e personelit akademik, të bazuara në vlerësimin/pikëzimin e kritereve të pranimit, të miratuara paraprakisht.
10. Nuk paraqiten me vërtetësi të gjitha burimet financiare të këtij programi studimi. IAL nuk harton një raport të detajuar me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve.
11. Nuk sigurohet transparenca në lidhje me vendimmarrjen e Bordit të Administrimit për mbarëvajtjen financiare të këtij institucioni jopublik të arsimit të lartë.
12. Nuk hartohet një Raport Auditimi i Brendshëm nga struktura përkatëse, në lidhje me eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.
13. Në aspektin cilësor, në sallat e leksioneve dhe të seminareve ajrimi ishte i pamjaftueshëm dhe deri diku edhe ndriçimi i tyre. Duke qenë nën nivelin e tokës sallat e leksioneve dhe seminareve ku zhvillohej mësim për studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Shkenca Juridike” ishin pa dritare prandaj nuk arrihej të sigurohej një ajrim i bollshëm.

c. Mundësitë:


1. Kapaciteti profesional dhe eksperienca e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi krijon një premisë për ecurinë pozitive të këtij programi.

d. Pengesat:

1. Tregu i punës është i pakonsoliduar dhe nuk afron mundësi të shumta për punësimin e studentëve të diplomuar në drejtësi apo shkenca juridike.

Rekomandime:

1. Duhet të hartohet një plan veprimi deri në vitin 2022, me masa konkrete dhe të matshme për të arritur treguesit strategjik të zhvillimit institucional.
2. Raportet e vetëvlerësimit të shoqërohen me analizën e mangësive dhe shkaqeve të tyre, si dhe me masa konkrete për evitimin e tyre.
3. Formimi profilizues që merr studentit gjatë këtij programi studimi Master Shkencor, duhet të jetë i tillë që të justifikojë shtesën e emërimit të programit: *me profile në “E drejtë publike dhe*



administrative”, “E drejtë private” dhe “E drejtë penale”.

4. Syllabuset të jenë më të qartë sa i përket kompetencave që studentët marrin nga lënda e caktuar.
5. Të hartohet një studim real i nevojave të tregut të punës dhe i mundësisë së punësimit të studentëve.
6. Pedagogët titullarë të lëndëve të përputhen sa më shumë të jetë e mundur me pedagogët e angazhuar në mësimdhënie.
7. Të mos angazhohet në mësimdhënie, për këtë program studimi (Master i Shkencave), asnjë pedagog me diplomë Msc.
8. Të rritet pjesëmarrja e stafit akademik të këtij programi studimi në punë kërkimore-shkencore.
9. Të hartohen tabela pikëzimi ku pikëzohen të gjitha kriteret e miratuara të rekrutimit të stafit akademik, me kohë të plotë apo të pjesëshme (psh. pikë për diplomën, për punimet shkencore, konferencat, pjesëmarrja në borde, gjuhët e huaja, etj.).
10. Të hartohet një raport i hollësishëm financiar mbi kostot dhe burimet financiare të programit të studimit.
11. Vendimarrja e Bordit të Administrimit të bëhet më transparente.
12. Struktura përkatëse e auditimit të brendshëm të hartojë raporte periodike, në lidhje me efikasitetin e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.
13. Sallat e leksioneve dhe seminareve ku zhvillohej mësim, të cilat janë nën nivelin 0, të pajisen me sisteme aspirimi më cilësore.

III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EXTERNAL EVALUATION REPORT, BY SWOT METHOD (STRENGTHS - WEAKNESSES - OPPORTUNITIES - THREATS)

a. Strengths:

1. AU is seriously committed to improve the study program. AU, in its Strategic Plan for Institutional Development 2017-2022, has foreseen as one of its objectives exactly the improvement of study programs. It is also a fact that the relevant structure is engaged every year in revising the curricula in order to improve them.
2. The Master of Science Degree Program in Law Sciences creates sustainable knowledge bases for third cycle of studies (doctoral studies).
3. There is a high level of internal cooperation between the AU management structures and of the information exchange between them.
4. The institution has a significant number of agreements with different actors, both public and private ones;
5. The online library "QUESTIA" provides sufficient and appropriate literature for students and academic staff, providing opportunities for successful realization of the study program and scientific research.
6. The institution (HEI), through the Department, the Secretary, the "Student Coordination and Support Office" and the "Career and Alumni Office" keeps students informed about the study program and its elements, the progress of fulfilling the curricular obligations, accreditation and



the validity of the study program, the status and the student rights and obligations. The information provided for the study program is easily consultable to students and is provided in a variety of written and electronic forms.

7. The institution (HEI) keeps records of student employment as well as takes measures to mediate their employment.

b. Weaknesses:

1. The Institutional Strategic Development Plan 2017-2022 is not accompanied by an action plan with concrete and measurable measures.
2. There is no comparative analysis and reflection on the deficiencies found in the semester or the annual self-evaluation report.
3. The title of the study program is "Master of Science in "Law Sciences" and is in accordance with the levels set by the Albanian Qualification Framework. The addition of titles *with profiles in "Public and Administrative Law", "Private Law" and "Criminal Law"* is not fully justified, considering the amount and quality of profiling training the student receives.
4. The competences provided in the Study Regulation are very general and unclear. Furthermore, the syllabuses are not always clear in terms of the competences that students receive from the subject and in terms of the learning objectives.
5. It is not clear if the Master of Science degree program in Law Sciences is designed according to market needs.
6. Only 4 (four) of the subjects presented in the syllabus are entitled to the academic staff who are currently engaged in teaching.
7. In the academic year 2017-2018, two lecturers with Msc. degree are engaged in teaching. In the academic year 2018-2019 there is only one lecturer with a Msc. degree who is engaged in this study program.
8. Most of the academic staff engaged in the Master of Science degree program does not appear to have been engaged in scientific research for the realization of the study program. Publications and scientific studies are scarce and the institution does not have an effective policy to promote scientific research.
9. The HEI does not follow transparent public competition procedures for the recruitment of academic staff based on the scoring of the pre-approved admission criteria.
10. Not all financial resources of this study program are truly presented. The HEI does not compile a detailed report with detailed financial data of the costs of implementing the study programs.
11. Transparency regarding the decision-making of the Board of Administration on the financial performance of this HEI is not ensured.
12. There is no Internal Audit Report regarding the efficiency of the use of student fee income in order to enhance the quality of studies, which should be prepared by the relevant structure.
13. Regarding the quality of the lecture and seminar rooms, the ventilation of these classrooms was insufficient and to some extent even their lighting. Being below ground level, the lecture and seminar rooms for students of the study program Master of Science in "Law" were without windows and therefore there was no possibility to provide adequate ventilation.

c. Opportunities:

1. The professional capacity and experience of the academic staff engaged in this study program creates a premise for the positive performance of this program.

d. Threats:

1. The labor market is unconsolidated and does not offer many opportunities for graduate students in law or law sciences.

Recommendations:

1. An action plan should be drawn up by 2022, with concrete and measurable measures to achieve strategic indicators of institutional development.
2. The institutional self-evaluation reports should be accompanied by an analysis of their deficiencies and causes, as well as concrete measures to avoid them.
3. The profiling training the student receives during this Master of Science degree program should be as such as to justify the addition of the program title: *with profiles in "Public and Administrative Law", "Private Law" and "Criminal Law"*.
4. The syllabuses should be clearer in terms of the competences students receive from the subject.
5. A realistic survey of labor market needs and student employment opportunities should be developed.
6. The entitled lecturers of the subjects of the study program should be as closely aligned as possible with those engaged in teaching.
7. No lecturer with a Msc. degree should be engaged in teaching for this Master of Science degree program.
8. The participation of the academic staff of this study program in scientific research should be increased.
9. The scoring tables that outline all pre-approved criteria for full-time or part-time academic staff recruitment should be designed and approved (e.g. the scores for diploma level of applicant, research papers, conferences, board participation, foreign languages, etc.).
10. A detailed financial report on the costs and financial resources of the study program should be developed.
11. The decision-making of the Board of Directors should become more transparent.
12. The relevant internal audit structure should draw up periodic reports on the efficiency of using student fee revenue to enhance the quality of studies.
13. Lectures and seminars classrooms, which are below the ground level, should be equipped with better quality systems of aspiration.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

PhD. Ildir PEÇI
Dr. Artan SPAHIU